

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Spektori i mbikëqyrjes, rregullativës bankare dhe stabilitetit financiar
Drejtoria e stabilitetit financiar dhe rregullativës bankare



RAPORT PËR RREZIQET E SISTEMIT BANKAR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË PËR VITIN 2017

Prill, 2018

Përkthim në gjuhën shqipe: Grupi punues i Fakultetit të biznesit dhe ekonomisë pranë
Universitetit të Evropës Juglindore Tetovë (i pa lekturuar).



PËRMBAJTJA

Rezyme	4
I. Struktura e sistemit bankar	8
1. Struktura e sistemit bankar	9
1.1 Karakteristikat bazike të modeleve afariste të bankave	9
1.2 Numri i bankave dhe qasja gjer te shërbimet bankare.....	10
1.3 Punësimi në sektorin bankar	12
1.4 Struktura pronësore dhe koncentrimi i sistemit bankar	13
II. Rreziqet në punën bankare	16
1. Rreziku i kredisë	20
1.2 Kapaciteti i bankave për menaxhim me rrezikun kreditor	25
1.3 Burime të tjera të mundshme të realizimit të rrezikut të kredisë.....	26
1.4 Stres-testimi i rezistencës së sistemit bankar për të rritur rrezikun e kredisë.....	34
2. Rreziku i likuiditetit	36
2.1 Dinamika dhe përbërja e mjeteve likuide	36
2.2 Treguesit e likuiditetit	41
2.3 Struktura e maturitetit të mjeteve dhe detyrimeve.....	43
2.4 Simulimet e stresit për goditjet e likuiditetit	45
3. Rreziku valutor	47
4. Rreziku nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteve bankare	51
5. Rreziku i josolventitetit	56
5.1. Treguesit e solventitetit dhe të kapitalizimit të sistemit bankar dhe niveli i rrezikshmërisë së aktiviteve.....	57
5.2. Lëvizjet dhe cilësia e mjeteve vetanake të sistemit bankar.....	61
5.3. Lëvizjet dhe struktura të kërkesave kapitale dhe kapitalin e lirë të sistemit bankar	63
5.4. Stres-testi тестирање e qëndrueshmërisë së sistemit bankar ndaj goditjeve hipotetike ...	64
III. Ndryshimet më të rëndësishme bilancore dhe profitabiliteti i sistemit bankar ..	66
1. Aktivitetet e bankave	67
1.1 Kredi të subjekteve jofinanciare	69
1.2 Depozite të subjekteve jofinanciare.....	72
1.3 Aktivitete tjera	75
2. Profitabiliteti	79
2.1 Tregues të profitabilitetit dhe efikasitetit të sistemit bankar	79
2.2 Lëvizja e normave të interesit dhe diapazonit të normave të interesit	83
Shtojca 1	88



Rezyme

Bankat vendore gjatë vitit 2017 kanë vepruar në kushte politike jo stabël si dhe me aktivitete të zvogëluar në vend kryesisht në gjysmë vjetorin e parë të vitit 2017, që gradualisht është stabilizuar gjatë gjysmës së dytë të vitit. Mjedisi i paparashikueshëm i brendshëm ndikoi në perceptimet e subjekteve ekonomike vendase dhe abstenimin e tyre nga aktivitetet investuese, të cilat në mënyrë të pashmangshme u reflektua edhe në rritjen modeste vjetore të gjithsej aktiveve të sistemit bankar prej 3.9%. Rritja e parëndësishme e veprimtarive bankare është reflektim i dinamikës së depozitave të subjekteve jo financiare si burim kryesor i financimit të bankave vendase, të cilat në gjysmën e parë të vitit kanë shënuar stagnim, ndërsa në gjysmën e dytë ato kanë rinovuar rritjen e tyre. Kjo paraqet shenjë të qartë për lidhjen pozitive midis stabilizimit të ambientit politik dhe stabilizimit të pritjeve të subjekteve ekonomike. Megjithatë, ringjallja e rritjes së depozitave në gjysmën e dytë të vitit akoma nuk është në një shkallë që mund të kompensojë plotësisht zhvillimet stagnante në periudhën e mëparshme gati dyvjeçare të një politike të paqëndrueshme.

Depozitat e qytetarëve përbëjnë bartësin kryesor të rritjes vjetore të depozitave në gjithsej depozitat e vitit 2017 (me një pjesëmarrje prej mbi 80% në rritjen vjetore), me një rritje pak më të sforcuar të depozitave në denar krahasuar me ato valutore. Nga ana tjetër, në strukturën e maturimit të depozitave vazhdoi tendenca e vërejtur në dy vitet e fundit me një prirje më të theksuara të depozituesve, vazhdoi të rritet kryesisht në depozitat në të parë, ndërsa në një masë më të vogël të depozitave afatgjata, në llogari të rënies së depozitave afatshkurtra. Krahas zhvillimeve politike në vend, për këtë trend të transformimit të strukturës së maturimit të depozitave të bankave kontribuuan edhe rendimenti relativisht i ulët i ofruar nga produktet e depozitave në afatshkurtër, që në të vërtetë është një reflektim i trendit të normave të ulëta të interesit në nivel global.

Në kushtet të një kujdesi të lartë të subjekteve vendore jo financiare gjatë marrjes së vendimeve të investimeve ose të vendimeve konsumatore dhe rrjedhimisht, zvogëlimit të kërkesës për kredi në gjysmën e parë të vitit 2017, bankat megjithatë mbajtën një ritëm të kënaqshëm të aktivitetit kreditues. Ashtu që gjithsej kreditë e subjekteve jo financiare në vitin 2017 u rritën për 5.9% që paraqet një rritje më të shpejtë në krahasim me rritjen e gjithsej mjeteve dhe depozitave të bankave në vitin 2017. Rritja e kredive kryesisht ishte rrjedhojë nga rritja e përkrahjes kredituese të bankave ndaj familjeve, e cila kontribuoi me rreth tre të katërtat në rritjen e përgjithshme vjetore të kredive të subjekteve jo financiare. Rritja e kreditimit të familjeve kryesisht ishte pasojë nga format e ndryshme të kreditimit të dedikuar për financimin e konsumit dedikuar qytetarëve (rreth 63% të rritjes vjetore), ndërsa një pjesë më e vogël ishte orientuar kah kreditimi banesor (rreth 37% e rritjes vjetore). Përkrahja kredituese e sektorit korporativ, edhe pse ishte më e dobët krahasuar me kreditimin e familjeve, megjithatë shënoi përsheptim në raport me vitin 2016. Transformimi i përgjithshëm i portofolit kreditues të bankave vazhdoi edhe në vitin 2017, që shihet nga rritja e kredisë denarike gjatë një ulje vjetore të kredive në valutë të huaj.

Në vitin 2017, kreditë jofunksionale të sistemit bankar shënuan rritje prej 2%, kryesisht nga rritja më e shpejtë e kredive jofunksionale të shoqërive jo financiare, të cilat përsëri kanë të bëjnë me mos realizimin e detyrimeve kredituese nga ana e disa klientëve më të mëdhenj korporativ të bankave.



Te familjet, rritja e kredive jofunksionale është paksa më e moderuar dhe rrjedh nga kreditë jofunksionale konsumatore, që është tregues për realizimin e pjesëshëm të rreziqeve të lehtësimit të kushteve për kreditimin e konsumatorëve në të kaluarën. Pjesëmarrja e gjithsej kredive jofunksionale në nivel vjetor kah fundi i vitit 2017 shënoi një rënie të lehtë duke shënuar 6.3%. Në aspekt të strukturës sektoriale, kreditë jofunksionale edhe matej kanë pjesëmarrje kryesisht më të lartë të krediteve të shoqërive jo financiare (10% në fund të vitit 2017) në krahasim me kreditë të qytetarëve (2.4% në fund të vitit 2017). Mbulimi i kredive jofunksionale me vlerën korrigjues të ndarë është i lartë, me çka pjesëmarrja e kredive jofunksionale që nuk mbulohet nga vlera korrigjuese mbulon vetëm 7.9% të mjeteve të veta të sistemit bankar. Kjo tregon se rreziqet që lidhen me mos pagesën eventuale të plotë të kredive jo funksionale ose me krijimin e humbjeve të papritura për bankat janë të vogla. Niveli mesatar i rrezikut të kredive të rregullta për subjektet jo financiare të përcaktuara nga bankat në fund të vitit 2017 ishte 2.3% dhe në fund të vitit 2017 ishte më i lartë se norma vjetore e jo arkëtueshme e ekspozimit të kredisë me status të rregullt prej 1.8% .

Dinamika e cilësisë së portofolit të kredive të bankave lidhet me ndikimin e faktorëve sistematikë, të cilët, si rregull, nuk mund të ndikojnë bankat, para së gjithash në rritjen e potencialit dhe qëndrueshmërisë së rritjes së ekonomisë dhe zbatimin e reformave strukturore në atë drejtim, e cila nga ana tjetër në mënyrë të pashmangshme kërkon si një ambient të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm politik. Megjithatë, krahas faktorëve sistemor, ekzistojnë faktor të ndërlidhur me sjelljen e tregut, proceset politike dhe kredituese të bankave ndaj të cilëve udhëheqësit e bankave mund të ndikojnë ose ti nderojnë ato. Kështu, si një burim i mundshëm i realizimit eventual të rrezikut të kredisë në të ardhshmen, është zhvillimi, cilësia, përkatëshmëria dhe ndryshimet në kohë të kushteve kredituese (prolongim ose ristrukturim). Një rol të rëndësishëm ka edhe rreziku inherent nga ristrukturimi i rrjedhave para tek krediteve me një shlyerje të njëhershme të kryegjësë, që përfshinë gati një të tretën e gjithsej kredive të shoqërive jo financiare. Pjesëmarrja e lartë e kredive tek të cilët është inkorporuar çfarëdo qoftë sigurie, veçanërisht të shoqëritë jo financiare, nga njëra anë e zbusin riskun kreditor të ndërmarrë sepse ajo përfaqëson një burim potencial dytësor të arkëtimeve, por, nga ana tjetër, thekson rëndësinë e cilësisë së sigurisë. Pra, marrja e mundshme e sigurisë për bankat është në fakt një zëvendësim i një lloji rreziku (rreziku i kredisë), me rreziqe të tjera që lidhen me zhvillimet e tregut të mjeteve që janë ndërmarrë për arkëtim të kredive jofunksionale, a në veçanti, tregu i formave të ndryshme të pasurive të patundshme si një nga format më të shpeshta të sigurisë.

Për shkak të rritjes modeste vjetore të mjeteve likuide (në vlerë prej 0.8%), pjesëmarrja e tyre në gjithsej mjetet e bankave, në baza vjetore, është më e ulët për rreth një pikë përqindjeje dhe arriti në 29.8% në fund të vitit 2017. Treguesit e mbulimit të kategorive të ndryshme të detyrimeve të bankave me mjete likuide gjithashtu kanë shënuar rënie kryesisht në vitin 2017, por janë në nivel të kënaqshëm, gjë që mundëson menaxhimin e suksesshëm të likuiditetit nga bankat. Rritja e maturimit të aktiveve likuide të bankave për shkak të përpjekjeve për të arritur kthime më të larta nga investimi i tyre në instrumente afatgjatë, në kushtet e rritjes graduale të pjesëmarrjes së depozitave me afat në strukturën e burimeve të financimit të bankave, kontribuuan në thellimin e hendekut midis mjeteve dhe detyrimit sipas maturimit së mbetur kontraktuale, e cila për shkak të transformimit valutor të kryer nga bankat është më e theksuar me hendekun e këmbimit valutor. Nga ana tjetër, ekspozimi i drejtpërdrejtë i bankave valutore ndaj bankave vendase në fund të vitit 2017 ishte në nivelin më të ulët në pesë vitet e fundit, gjë që konfirmohet nga raporti i hendekut mes mjeteve dhe detyrimeve me komponentë valutore dhe mjeteve vetanake të bankave, të cilat u ulen në 6.4%.



Në fillim të vitit 2017, Banka popullore vazhdoi me normalizimin e politikës monetare, duke rritur ofertën e bonove të thesarit dhe në dy tentime e ka ulur normën e interesit me 0.5 pikë përqindje, duke rikthyer kështu normën bazë të interesit në nivelin që nga fillimi e vitit 2016 (3.25%). Këto ndryshime rezultojnë nga arritja e ekuilibrit në tregun valutor dhe mungesa e jo stabilitetit në tregun e depozitave, i cili ishte i pranishëm në gjysmën e parë të vitit 2016. Ekuilibri i arritur i tregut u mbajti gjatë vitit 2017, pavarësisht nga zhvillimet e paqëndrueshme politike, të cilat në fakt ishin bazë për uljen e mëtejshme të normave të interesit për bonot e thesarit nga Banka popullore në fillim të vitit 2018, si dhe normat e interesit për depozitat e disponueshme brenda ditës dhe në shtatë ditë.

Në vitin 2017, sistemi bankar tregoi fitim në shumën totale prej 6.6 miliardë denarë, që është më shumë për 3.6% në krahasim me fitimin e realizuar në 2016. Kundrejt vitit të kaluar kur të ardhurat neto nga interesi kanë pasur kontributin më të madh në rritjen e fitimeve bankare, në vitin 2017, kontribuuesit më të mëdhenj në rritjen e fitimit kishin të ardhura jo nga interesi. Gjegjësisht, në vitin 2017 ka pasur një ngadalësim në rritjen vjetore e të ardhurave neto nga interesat e bankave, për shkak të rënies së të ardhurave nga interesat e kompanive jo financiare. Nga ana tjetër, rritja e të ardhurave jo nga interesat nuk vjen nga futja e produkteve ose shërbimeve të reja financiare, por kryesisht është rezultat i rritjes së të ardhurave jo operative të një natyre kryesisht të papërsëritshme, siç janë arkëtimet e kërkesat paraprakisht të shlyera dhe fitimet kapitale nga shitja e mjeteve. Kostoja e zhvlerësimit u rrit me 11.1% në baza vjetore, gjë që gjithashtu kontribuoi në rritjen më të ngadalshme vjetore të fitimit të sistemit bankar. Rritja e ngadalshme e fitimit ndikoi gjithashtu në treguesit e profitabilitetit dhe efikasitetit të sektorit bankar. Pas një tendence disa vjeçare të rritjes së qëndrueshme, normat e kthimit të aktivitetit mesatar dhe kapitalit mesatar dhe rezervat shënojnë një rënie minimale prej 0.1 pikë përqindjeje, dhe në fund të vitit 2017 ato arritën respektivisht në 13.5% dhe 1.4%. Sistemi bankar i Republikës së Maqedonisë në vitin 2017 mbajti me sukses solventitetin e tij. Pozicionet kapitale të bankave shënuan rritje më të shpejtë krahasuar me aktivet e ponderuara me rreziqet, kryesisht për shkak të riinvestimit të disa prej fitimeve të bankave dhe lëshimit të instrumenteve subordinuese. Kjo mundësoi një rritje të treguesve të solventitetit, me çka norma e mjaftueshmërisë së kapitalit në fund të vitit shënoi 15.7% ose më shumë me gjysmë pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2016.

Bankat në vitin 2017 janë përshtatur me kërkesat e reja rregullatore në lidhje me strukturën e mjeteve të veta dhe shtresat mbrojtëse të kapitalit. Sasia relativisht e lartë dhe cilësia e mjeteve të veta që disponojnë bankat, mundësuan që ky proces i përshtatshmërisë me kërkesat e kapitalit të ri të kalojë pa kufizime të mëdha në aktivitetet ose nevojën për kapitalizim të ri më të rëndësishëm. Me këtë edhe në sistemin bankar vendas u aplikua një nga komponentët më të rëndësishëm të marrëveshjes ndërkombëtare Basel 3. Në përputhje me këto kërkesa të reja për kapital, bankat, përveç raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit (në nivelin 8%), janë të detyruar të llogarisin dhe ruajnë nivelin minimal të raportit të kapitalit themelor (në nivelin 6%), si dhe normën e kapitalit të rregullt themelor (në nivelin 4.5%). Përveç kësaj, secila prej bankave ka një detyrim për të ruajtur të ashtuquajturin shtresë mbrojtëse për ruajtjen e kapitalit (në nivelin 2.5% të aktiveve të ponderuara me rreziq). Banka popullore, duke zbatuar metodologjinë e përshkruar në përputhje me standardet ndërkombëtare, përcaktoi të ashtuquajturat bankat e rëndësishme sistematike (shtatë banka), të cilat janë të detyruara të përmbushin të ashtuquajturat shtresë mbrojtëse të kapitalit për bankat me rëndësi sistimore, një pjesë më 30.9.2017, dhe pjesa e mbetur më së voni gjer më 31.3.2018.



Banka popullore, në rolin e një autoriteti kompetent mbikëqyrës, gjithashtu përcaktoi një shtesë kapitale të përshtatshme për profilin e rrezikut të vlerësuar të bankave të veçanta. Ndryshimet e shprehura në kornizën rregullatore dhe aplikimi i tyre zyrtar, krahas përcaktimit të konkurrueshmërisë ndërkombëtare të sistemit bankar vendas në mënyrë që të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të mjaftueshmërisë së kapitalit, pritet të kontribuojnë në forcimin e mëtejshëm të pozicionit kapital të bankave, si dhe sjelljen e mundësisë për një fleksibilitet më të madh në lidhje me menaxhimin dhe mbajtjen e mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave.



I. Struktura e sistemit bankar




1. Struktura e sistemit bankar

1.1 Karakteristikat bazike të modeleve afariste të bankave

Grafik 1

Struktura e aktivitet (lartë) dhe pasivit (poshtë) të bankave, më 31.12.2017 në përqindje



Burimi: BPRM, sipas të dhënave të dorëzuara nga bankat.
Radhitja e bankave është e rastësishme.

Modeli bazë afarist i bankave në RM, si ndërmjetës financiar nuk kanë pësuar ndryshime në vitin 2017.

Depozitat e familjeve mbizotërojnë në gjithsej pasivin, përkatësisht janë burimi më i rëndësishëm i financimit të aktiviteteve bankare (në vitin 2017 pjesëmarrja e tyre në gjithsej aktivin arriti 50.8% apo 1.1 pikë përqindje në raport me vitin 2016). Te dhjet nga pesëmbëdhjetë bankat në vend, depozitat e familjeve kanë pjesëmarrje më të lartë në gjithsej burimet e mjeteve¹. Në anën e aktivitet, trendi i sforcuar i kreditimit të familjeve në disa vitet e fundit është i pranishëm edhe në vitin 2017, duke arritur pjesëmarrjen prej 29.2% (rritje prej 1.6 pikë përqindje).

Pjesëmarrja e kredive të shoqërive jo financiare² u zvogëluar në 0.1 pikë përqindje dhe në 31.12.2017 shënoi 29.9% në gjithsej aktivin e sistemit bankar.

Analizuar në veçanti bankat, orientimi kredituese i bankave nuk kanë ndryshime në raport me vitin paraprak, përkatësisht gjashtë bankat më shumë e më shumë orientohen kah kreditimi i shoqërive jo financiare, pesë banka kryesisht kreditojnë familjet, tre bankat në mënyrë të barabartë financojnë të dy sektorët, ndërsa një bankë plasun kredi te bankat vendore (si ndërmjetësues për miratimin e linjave kreditore nga institucionet financiare ndërkombëtare).


Struktura e të hyrave të përgjithshme më 31.12.2017 korrespondon me modelin tradicional

¹ Te një bankë depozitat nga shoqëritë jo financiare kanë pjesëmarrje më të madhe në pasiv, ndërsa te tre bankat depozitat e familjeve dhe nga shoqëritë jo financiare kanë pothuajse pjesëmarrje të njëjtë. Vetëm BMPZH SHA Shkup financohet nga linja kreditore nga institucionet financiare ndërkombëtare, të cilat i plasun gjer te shfrytëzuesit përfundimtarë nëpërmjet bankave të tjera në vend.

² Kreditë për kompanitë jo financiare dhe familjeve analizohen në baza neto (duke marrë parasysh zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar të huave), por përfundimi është i njëjtë edhe nëse kreditë janë analizuar në baza bruto.




Grafik 2
Struktura e të ardhurave të bankave në vitin 2017 në përqindje



Burimi: BPRM, sipas të dhënave të paraqitura nga bankat.
Radhitja e bankave është e rastësishme.

Grafik 3
Struktura e shpenzimeve të përgjithshme në vitin 2017 në përqindje



Burimi: BPRM, sipas të dhënave të paraqitura nga bankat.
Radhitja e bankave është e rastësishme.

të afarizmit në punën e bankave. Kështu, të ardhurat nga interesi neto, me një pjesëmarrje prej 65%, janë më të rëndësishmet në strukturën e të ardhurave të përgjithshme, pavarësisht rënies së pjesëmarrjes së tyre me 2 pikë përqindje krahasuar me vitin 2016.

Orientimi më i madh i bankave për të punuar me familjet ka vazhduar gjatë vitit 2017, i cili perceptohet si një ndryshim në strukturën sektoriale i të ardhurave nga interesi neto. Pra pjesëmarrja e interesit neto nga puna me shoqëritë jo financiare është zvogëluar për 4.2 pikë përqindje në krahasim me vitin 2016 në llogari të pjesëmarrjes së të hyrave neto të interesit nga puna me familjet, për 2.6 pikë përqindje. Kështu, pjesa e të ardhurave nga interesi neto nga aktiviteti me të dy sektorët konvergojnë në nivelin 29% i të ardhurave të përgjithshme.

Shpenzimet më të rëndësishme në nivel të sistemit bankar janë shpenzimet për zhvlerësimin e aktiveve financiare dhe jo financiare dhe shpenzimet për punonjësit. Kah fundi i vitit 2017, zhvlerësimi i vlerës ka një pjesëmarrje individuale më të lartë në gjithsej të ardhurat përgjithshme, që është e rritur për 3,5 pikë përqindje për gjatë vitit 2017. Gjithashtu edhe shpenzimet dedikuar të punësuarve shënojnë rritje pak më të vogël (për 1,2 pikë përqindje) dhe pozicionohet në vendin e dytë sipas pjesëmarrjes së tyre.

Struktura e shpenzimeve ka treguar diferencën të konsiderueshme për bankat në veçanti. Kështu, në varësi të ekspozimit aktual të bankave ndaj rrezikut të kredisë, dallimet janë të dukshme të pjesëmarrjes së zhvlerësimit të përgjithshëm të shpenzimeve nga bankat individuale.

1.2 Numri i bankave dhe qasja gjer te shërbimet bankare

Më 31.12.2017, në Republikën e Maqedonisë funksionojnë shtatëmbëdhjetë institucione depozitare, përkatësisht pesëmbëdhjetë janë



Tabela 1
Tregues të krahasueshmërisë së numrit të banorëve për bankë dhe për njësi biznesi të bankave

Shteti	Numri i banorëve për bankë	Shteti	Numri i banorëve për njësi afariste bankare
Luksemburgu	4,030	Qiproja	1,559
Austria	12,947	Spanja	1,612
Malta	17,324	Franca	1,791
Qiproja	18,852	Italia	2,068
Lituanua	32,825	Portugalia	2,098
Mali i Zo	41,481	Austria	2,212
Gjermania	50,291	Bullgaria	2,429
Danimarka	52,360	Luksemburgu	2,505
Polonia	59,343	Gjermania	2,566
Suedia	61,139	Polonia	2,782
Portugalia	70,349	Belgjika	3,379
Hungaria	82,247	Slovenia	3,541
Letonia	85,607	Hungaria	3,580
Estonia	92,740	Kroacia	3,670
Slovenia	108,641	Rumania	4,118
Italia	110,906	Slovakia	4,197
Belgjika	119,064	Serbia	4,235
Franca	122,666	Malta	4,249
Kroacia	130,958	Greqia	4,624
Maqedonia	138,085	Maqedonia	4,851
Holanda	173,256	R.Çeke	5,390
Spanja	179,305	Suedia	5,681
Shqipëria	180,377	Lituanua	5,709
Rep.Çeke	188,461	Danimarka	5,736
Slovakia	193,795	Shqipëria	5,854
Serbia	228,270	Letonia	7,544
Bosna dhe Hercegovina	234,399	Holanda	10,143
Greqia	239,639	Estonia	13,292
Bullgaria	264,955	Mali i Zi	-
Rumania	534,063	Bosnja dhe Hercegovina	-


Burimi: BPRM, EU Structural Financial Indicators 2016, BSCEE Review 2016, ueb faqet e Unionit Evropian, Banka Botërore, Banka popullore e Shqipërisë (Supervision Annual Report 2016), Banka popullore e Serbisë (Sektori bankar në Serbi, Raporti për III tremujorin e vitit 2017).

Shënim: Të dhënat për Maqedoninë janë për 31.12.2017, për Serbinë 30.9.2017, ndërsa të dhënat për vendet tjera kanë të bëjnë për 31.12.2016.

që janë të shërbyer nga një bankë, përkatësisht nga një njësi afariste, Maqedonia gjendet në pjesën e dytë të tabelës së vendeve të analizuar, që gati se është i pandryshuar nga viti i kaluar.

1.3 Punësimi në sektorin bankar

Grafik 5
Numri i të punësuarve në sistemin bankar



Burimi: BPRM, sipas të dhënave të paraqitura nga bankat.

Në vitin 2017, numri i personave të punësuar në sistemin bankar është zvogëluar për 56⁶ dhe shënon 5.929.

Pjesëmarrja e të punësuarve me minimum arsimim të lartë edhe mëtej shënon rritje duke arritur 78.8%, ose rritje prej 2.1 pikë përqindje, gjë që tregon përmirësim të mëtejshëm të strukturës kualifikuese të punësuarve në sektorin bankar.


Produktiviteti i sistemit bankar vazhdon të përmirësohet.

Për gjatë vitit 2017, aktivi rritet, por e ngadalësuar në raport me vitin paraprak, ndërsa, nga ana tjetër, ka një ndryshim të dukshëm negativ në numrin e të punësuarve. Analizuar në bazë të bankave në veçanti, matur nëpërmjet vlerës së aktivitetit sipas punonjësve, produktiviteti është përmirësuar te njëzet banka, ku në shtatë banka nga ato është rezultat i rritjes së aktivitetit gjatë një zvogëlimi të njëkohshëm të numrit të punësuarve te

⁶ Zvogëlimin më të madh të punësuarve kishte te një bankë (për 53 persona) dhe te një bankë e vogël (për 21 persona). Nga ana tjetër, rritje më të theksuar të punësuarve ka tek një bankë (për 38 persona).



Grafik 6
Aktivi për punonjës*
në mijë denarë



Burimi: BPRM, sipas të dhënave të dorëzuara nga bankat.

*BMPZh nuk është inkorporuar në analizë për shkak të llojit të aktiviteteve të cilat i realizon.

katër nga ato, ajo është rezultat i rritjes së përsheptuar të aktivitetit nga rritja e të punësuarve, a të një bankë rritja e vlerës së aktivitetit sipas punonjësve rrjedh nga rënia e shpejtë e numrit të punonjësve në krahasim me rënie të vlerës së aktivitetit. Edhe krahas rritjes së produktivitetit në nivel të sistemit bankar sipas rënies së theksuar të numrit të punonjësve të një bankë, shtrirja mes bankës me produktivitet më të lartë dhe asaj me produktivitet më të ulët në mënyrë të theksuar u zgjerua, ndërsa shtrirja në mes tremujorit të parë dhe atij të tretë të treguesve dedikuar aktivitetit për punonjës pothuajse gati nuk kanë ndryshime në raport me vitin 2016.

1.4 Struktura pronësore dhe koncentrimi i sistemit bankar

Në vitin 2017, numri i bankave që janë në pronësi të aksionareve të huaja (njëmbëdhjetë), si dhe numri i filialeve të bankave të huaja (gjashtë) është i pandryshueshëm në krahasim me fundin e vitit 2016.

Tabela 2

Struktura e numrit të bankave dhe pozicioneve më të rëndësishme nga bilanci, sipas pronësisë përkatëse të bankave (me gjendje 31.12.2017) në milionë denarë dhe në përqindje


Lloji i pronësisë	Numri i bankave	Kapitali dhe Rezervat		Aktivi		Kreditë ndaj sektorit jofinanciar		Depozitat nga sektori jofinanciar		Gjithsej të hyra*		Rezultati financiar*	
		Vlera	në %	Vlera	në %	Vlera	në %	Vlera	në %	Vlera	në %	Vlera	në %
Bankat me pronësi dominante të aksionerëve të huaj	11	35,097	70.1%	325,711	70.5%	233,427	78.4%	236,629	69.7%	17,469	72.9%	5,502	83.9%
- Filialet e bankave të huaja	6	30,179	60.3%	267,316	57.9%	191,891	64.5%	195,970	57.8%	14,529	60.7%	5,084	77.6%
- Austria	1	2,348	4.7%	18,878	4.1%	12,540	4.2%	11,852	3.5%	914	3.8%	29	0.4%
- Bullgaria	1	1,201	2.4%	8,636	1.9%	5,879	2.0%	6,327	1.9%	353	1.5%	-5	-0.1%
- Greqia	1	11,590	23.1%	86,374	18.7%	63,998	21.5%	68,447	20.2%	5,326	22.2%	2,044	31.2%
- Sllovenia	1	7,395	14.8%	75,947	16.4%	53,481	18.0%	60,287	17.8%	4,483	18.7%	2,125	32.4%
- Turqia	1	4,670	9.3%	42,221	9.1%	28,458	9.6%	24,655	7.3%	1,788	7.5%	539	8.2%
- Franca	1	2,976	5.9%	35,258	7.6%	27,534	9.3%	24,403	7.2%	1,664	6.9%	351	5.4%
- Banka të tjera me pronësi dominante të huaj	5	4,918	9.8%	58,396	12.6%	41,536	14.0%	40,659	12.0%	2,940	12.3%	418	6.4%
- Bullgaria	2	1,743	3.5%	18,795	4.1%	12,555	4.2%	13,649	4.0%	970	4.0%	66	1.0%
- Gjermania	1	2,277	4.5%	22,910	5.0%	17,950	6.0%	14,504	4.3%	1,075	4.5%	293	4.5%
- Zvicra	2	899	1.8%	16,691	3.6%	11,031	3.7%	12,506	3.7%	895	3.7%	59	0.9%
Bankat me pronësi dominante të aksionerëve vendor	4	14,984	29.9%	136,281	29.5%	64,149	21.6%	102,652	30.3%	6,478	27.1%	1,053	16.1%
- Pronësi private	3	12,519	25.0%	123,797	26.8%	64,129	21.6%	102,652	30.3%	6,304	26.3%	964	14.7%
- Pronësi shtetërore	1	2,465	4.9%	12,484	2.7%	20	0.0%	0	0.0%	174	0.7%	90	1.4%
Gjithsej:	15	50,081	100.0%	461,992	100.0%	297,576	100.0%	339,281	100.0%	23,947	100.0%	6,555	100.0%

Burimi: BPRM, sipas të dhënave të dorëzuara nga bankat.

* Gjithsej të hyrat dhe rezultati financiar ka të bëjë me vitin 2017.




Grafik 7
Struktura pronësore e kapitalit dhe rezervave të sistemit bankar në përqindje



Burimi: BPRM, sipas të dhënave të dorëzuara nga bankat.

Grafik 8
Indeksi i Hirfendalit* në pikë indeksi



Burimi: BPRM, sipas të dhënave të dorëzuara nga bankat.

*Indeksi i Hirfendalit –përlloraget sipas formulës

$$HI = \sum_{j=1}^n (S_j)^2$$

ku S është pjesëmarrja e çdo banke në

në vlerën e përgjithshme të kategorisë së analizuar (për shembull: gjithsej aktivi, gjithsej depozitat, etj.), dhe n është numri i përgjithshëm i bankave në sistem. Kur indeksi lëviz në intervalin nga 1,000 në 1,800 pikë, niveli i përqendrimit konsiderohet i pranueshëm.

Strukturat e pronësisë së bankave nuk kanë pësuar ndryshime të theksuara edhe gjatë vitit 2017. Në sistemin bankar të Republikës së Maqedonisë mbizotërojnë bankat me pronësi aksionare të huaj edhe atë në të gjitha pozicionet e rëndësishme bilancore. Dominimi i tyre më i theksuar është te aktiviteti kreditues (78.4%) dhe te rezultati financiar (83.9%) që na shpie kah një paraqitje më agresive të këtyre bankave në tregun e kredive dhe realizimi më të lartë të profitit marginal. Sipas llojit të aksionarëve, institucionet financiare edhe matej, institucionet financiare kanë pjesëmarrje në strukturën pronësore të kapitalit dhe rezervave të sistemit bankar edhe përkundër zvogëlimit prej 1.7 pikë përqindje në llogari të rritjes së pjesëmarrjes së personave fizik. Në mes aksionareve të huaj, sipas vendeve të prejardhjes së tyre, pjesëmarrje më të lartë në gjithsej kapitalin dhe rezervat kanë aksionarët Grek dhe ato Slloven në nivel prej 21.3% dhe 14%, përkatësisht. Në vitin 2017, pjesëmarrja e kapitalit me prejardhje nga Gjermania⁷ shënon rritje prej 0.8 pikë përqindje. Pjesëmarrja e kapitalit të huaj në gjithsej kapitalin dhe rezervat e sistemit bankar u zvogëlua për 1.1 pikë përqindje, por ky zvogëlim para së gjithash është rezultat i rritjes më të madhe të kapitalit gjithsej dhe rezervave nga rritja e kapitalit të huaj.

Sipas madhësisë, disa banka janë vendimtare për sektorin e përgjithshëm bankar dhe ekonominë e vendit, ndërkohë që rritja e bankave të mesme gjithnjë e më shumë redukon rëndësinë e tre bankave më të mëdha në sistem. Sipas indeksit të Herfindallit koncentrimi në sistemin bankar edhe në vitin 2017 vazhdoi me trendin e zvogëlimit, ndërsa të gjitha vlerat e këtij indeksi janë në suaza të intervalit të pranueshmërisë. Treguesit CR5 dhe CR8⁸ të 31.12.2017 tregojnë rënie të theksuar

⁷ Gjatë vitit 2017, një bankë në pronësi të aksionarëve Gjerman qe dokapitalizuar nga person amë (nëpërmjet emetimit të fletë aksioneve të reja).

⁸ Treguesi CR5, përkatësisht CR3 e tregon pjesëmarrjen të kategorive të veçanta të analizuar (për shembull, aktivet) e pesë, përkatësisht tre bankat me vlerën më të lartë të asaj kategorie në vlerën totale të asaj kategorie të analizuar (për shembull, në gjithsej aktivin) në sistemin bankar.



Tabela 3

Treguesit e koncentrimt të pozicioneve më të rëndësishme nga bilancet te tre dhe pesë bankat më të mëdha

në përqindje


Pozicioni	31.12.2016		31.12.2017	
	CR3	CR5	CR3	CR5
Gjithsej aktive	58.2	74.3	57.8	74.6
Kreditë ndaj famijeve	62.9	79.2	61.5	78.8
Kreditë ndaj shoqërive joinanciare	55.5	74.9	53.0	73.4
Depozitat e famijeve	70.5	79.9	70.1	80.0
Depozitat e shoqërive jofinanciare	53.9	76.9	51.1	76.6
Rezultati financiar*	72.7	87.0	76.1	89.7
Gjithsej të hyra*	61.3	75.5	63.2	77.6

Burimi: BPRM, sipas të dhënave të paraqitura nga bankat.

*Të hyrat dhe rezultati financiar janë llogaritur për vitin 2017.

Grafik 9

Shpërndarja e pjesëmarrjes së aktivitetit sipas bankave



Burimi: BPRM, sipas të dhënave të dorëzuara nga bankat.

vjetore të të gjitha segmentet e punëve bankar, përveç në punën e tre bankave më të mëdha me kompanitë, e cila u zvogëlua për 2.5 pikë përqindje në anën e kredive dhe për 2.8 pikë përqindje në anën e depozitave. Pjesëmarrja e pesë bankave më të mëdha në gjithsej aktivin e sistemit bankar (74.6%), shënoi një rritje minimale prej 0.3 pikë përqindje, kundrejt zvogëlimit të pjesëmarrjes së tre bankave më të mëdha prej 0.4 pikë përqindje. Treguesit e pjesëmarrjes së tre dhe pesë bankave më të mëdha në gjithsej të ardhurat dhe rezultatit financiar tregojnë rritje. Shtrirja mes bankës me pjesëmarrje më të lartë në aktivin (22.7%) dhe asaj me pjesëmarrje më të vogël (0.6%) në sistemin është thuhet në të njëjtin nivel të lartë si edhe në vitin e kaluar, ndërsa dhjetë banka që përfshijnë një të katërtën e gjithsej aktivitetit, kanë pjesëmarrje individuale më pak se 5%.

Dominimi i disa bankave vërtetohet edhe nëse pjesëmarrja e aktivitetit sipas bankave i krahasojmë me ato shpërndarje normale⁹. Vërehet se shpërndarja e tyre është pozitivisht asimetrike ose asimetrike në të djathtë, pra disa banka kanë vlera "ekstreme" të këtij treguesi. Tre banka kanë pronat që tejkalojnë 15% dhe dhjetë banka janë nën mesataren e 7%.

⁹ Shpërndarja normale është shpërndarja e të dhënave në formën e një zile, ku mesatarja, mediana dhe moda, përkatësisht vlerat më e shpeshtë përshatet, me çka 68% e të dhënave shtrihen me një devijim standard nga mesatarja dhe 95% e vlerave shtrihen brenda dy devijimeve standarde nga mesatarja. Në disa vlera asimetrike pozitive shpërndarja e vlerave ekstreme janë në anën pozitiv të shpërndarjes dhe mesatarja është më e lartë se mediana dhe moda (për shkak të pranisë së vlerave përfundimtare të anës pozitive të shpërndarjes). E kundërta vlen për shtrirjen negative asimetrike, apo asimetrike në të majtë, ku mesatarja është më e vogël se moda.



II. Rreziket në punën bankare



Hitmap-ë për tregues të caktuar (me gjendjen më 31.12.2017) Vështrim i përgjithshëm i treguesve kryesorë të rrezikut në sektorin bankar

	Treguesi	Intervali	Trendi*	T4 2015	T1 2016	T2 2016	T3 2016	T4 2016	T1 2017	T2 2017	T3 2017	T4 2017	EU T2 2017
Solventiteti	Kapitali themelor në raport me aktivin ponderuar me rrezikun	>15%		31.3%	32.0%	32.2%	55.5%	54.8%	54.3%	54.3%	53.9%	51.5%	50.5%
		[12%-15%]		35.2%	52.0%	51.3%	28.1%	11.7%	13.8%	29.1%	29.5%	31.8%	39.7%
		<12%		33.6%	16.0%	16.5%	16.4%	33.6%	31.9%	16.6%	16.6%	16.7%	9.8%
Rreziku i kredisë	Kredita jofunksionale në raport me kredita bruto (për subjektet jo-financiare)	<3%		14.2%	14.5%	20.8%	21.0%	21.1%	22.0%	22.3%	22.3%	22.5%	44.3%
		[3%-8%]		28.3%	27.8%	53.9%	53.7%	53.5%	52.3%	50.1%	49.9%	52.2%	43.0%
		>8%		57.4%	57.7%	25.3%	25.3%	25.5%	25.7%	27.6%	27.8%	25.3%	12.7%
	Rezervat e ndara për kredita jofunksionale të subjektet jo-financiare/ Kredita jofunksionale të subjekteve jo-financiare	>55%		100.0%	100.0%	100.0%	91.9%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	10.9%
		[40%-55%]		0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	50.8%
		<40%		0.0%	0.0%	0.0%	8.1%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	38.3%
Efikasiteti	ROAE (Norma e këthimit mesazhar të kapitalit)	>10%		60.5%	63.7%	62.0%	66.4%	61.7%	52.9%	62.1%	61.9%	63.4%	12.0%
		[6%-10%]		3.1%	24.1%	6.5%	23.4%	29.6%	12.5%	1.7%	1.8%	25.1%	47.7%
		<6%		36.4%	12.2%	31.4%	10.2%	8.7%	34.5%	36.1%	36.4%	11.5%	40.3%
	Shpenzimet operative në raport me gjatësinë të hyrave të rregullta (Cost to income)	<50%		61.8%	69.7%	52.5%	68.9%	68.6%	67.9%	67.5%	67.4%	67.3%	14.7%
		[50%-60%]		10.3%	7.7%	21.5%	0.0%	10.1%	0.0%	0.0%	0.0%	9.4%	16.9%
		>60%		27.9%	22.6%	26.0%	31.1%	21.4%	32.1%	32.5%	32.6%	23.3%	68.4%
Struktura e bilancit	Kredita e subjekteve jo-financiare/Depozitat e subjekteve jo-financiare (Loan to deposit ratio)	<100%		75.2%	76.9%	78.4%	78.2%	77.6%	74.1%	73.0%	73.9%	73.5%	35.7%
		[100%-150%]		24.8%	23.1%	21.6%	21.8%	22.4%	25.9%	27.0%	26.1%	26.5%	51.7%
		>150%		0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	12.6%
	Gjatësi e detyrimit/Kapitali dhe rezervat (netë)	<12%		88.3%	88.7%	96.5%	96.6%	89.4%	97.7%	96.4%	96.2%	96.3%	27.3%
		[12%-15%]		9.5%	7.6%	1.2%	1.2%	8.3%	0.0%	1.4%	0.0%	1.4%	25.4%
		>15%		2.2%	3.7%	2.2%	2.2%	2.2%	2.3%	2.3%	3.8%	2.3%	47.4%

Burimi: NBRM.

* Intervalet janë marrë nga „EBA – Risk Dashboard Data as of Q2 2017”, me qëllim që të mundësohet krahasimi i treguesve të zgjedhur në vendin tone, në raport me BE.

** Treguesit për BE për tremujorin e dytë të vitit 2017 janë të dhënat më të fundit në dispozicion.

Metodologjia e përdorur për të ndërtuar hitmap-ë

Hitmapa lejon një pasqyrë të shpejtë të treguesve kryesorë të stabilitetit financiar, duke treguar llojin e rrezikut, treguesin specifik dhe zhvillimin e tij historik dhe të tri shportat në të cilat secila e dhënë është shpërndarë në kohë sipas intervalit (e gjelbër për shportën “më të mirë”, e verdhë për “mesatare” dhe e kuqe për shportën “më të keqe”). Përdoren të dhënat tremujore, duke filluar nga tremujori i katërt i vitit 2015 deri në tremujorin e katërt të vitit 2017. Për secilën vlerë të treguesit, shpërndarja përmes tre



shportave llogaritet sipas aktiveve të bankave që hyjnë në intervalin e duhur për treguesin në raport me totalin e aktiveve të sistemit bankar. Kështu, përderisa ka një rritje të dukshme në përqindjen e cilës do shporte, kjo do të thotë se më shumë mjete nga sistemi bankar janë alokuar në atë shportë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që më shumë banka janë përfshirë në atë shportë. Ngjyra në kolonën "trend" për secilin tregues mund të jetë e gjelbër, e verdhë ose e kuqe, në varësi të lëvizjeve të fundit të shportës "më të keqe" për treguesin e veçantë, krahasuar me gjithë serinë kohore. Nëse shporta "më e keqe" përparon pozitivisht (kur janë ndarë më pak mjete në të), ngjyra duhet të zhvendoset nga e kuqe në të gjelbër. Kështu, ngjyra përcaktohet duke llogaritur përqindëshin e tridhjetë e tre dhe gjashtëdhjetë e shtatë të serive kohore, për shportën "më të keqe". Nëse përqindja për tremujorin e fundit në shportën "më të keqe" është më e ulët se përqindëshi i 33-të, atëherë trendin e shënojmë me ngjyrë të gjelbër, në qoftë se është në mes të vlerës së përqindëshit të 33-të dhe 67-të, atëherë e shënojmë me ngjyrë të verdhë, dhe në qoftë se e tejkalon përqindëshin e 67-të, atëherë e shënojmë trendin me ngjyrë të kuqe. Ngjyra e gjelbër e trendit tregon në përmirësimin e treguesit konkret, në tremujorin e fundit, në raport me vrojtimit e kaluara.

Kjo qasje për të analizuar treguesit e caktuar mundëson që përmes ngjyrës për prirjen, të shihet nëse në shportën "më të keqe" janë të shpërndara më shumë ose më pak nga aktivet e sistemit bankar të përgjithshëm, si dhe të perceptohen zhvillimet e fundit të shportës "më të keqe" nga një tregues i veçantë në raport me vlerat e kaluara në të njëjtën shportë.

Për një lexim më të lehtë të hitmap-ës, japim një shpjegim të shkurtër të një prej treguesve, treguesi për kreditë me probleme në raport me bruto-kreditë për bankë për tremujorin e katërt të vitit 2017. Së pari, mjetet e atyre bankave që kanë vlerën e këtij treguesi më të vogël se 3% janë shprehur si përqindje e totalit të aktiveve dhe fitojmë se 24.2% e totalit të aktiveve është shpërndarë në shportën e gjelbër. Në shportën e verdhë janë aktivet e bankave që kanë vlerën e treguesit midis 3% dhe 8% dhe këtu bën pjesë gjysma e mjetet të sistemit bankar. Në të kuqen, shportën "më të keqe", është vendosur pjesëmarrja në totalin e aktiveve të sistemit bankar (25.3%) të aktivës së atyre bankave që kanë vlerë të treguesit mbi 8%. Pastaj, për të u përcaktuar trendi, kjo pjesëmarrje prej 25.3% për shportën "më të keqe" e krahasojmë me përqindëshin e 33-të dhe 67-të të serive kohore për shportën "më të keqe". Fitojmë që përqindëshi i 33-të është 25.4%, ndërsa përqindëshi i 67-të është 27.7%. Duke marrë parasysh se 25.3% është më e vogël se vlera për përqindëshin e 33-të, ngjyrën e trendit e vendosim të gjelbër, që do të thotë se ky tregues përmirësohet me kalimin e kohës. Përfundimi i njëjti mund të sjellët nëse krahasojmë pjesëmarrjen e mjetet në shportën "më të keqe" prej Q4 të vitit 2015 (57.4%) me pjesëmarrjen në Q4 të vitit 2017, e cila është përgjysmuar dhe është 25.3%, që është një tregues i qartë i përmirësimit.

Përfundim

Mund të konkludohet se rreziqet në sistemin bankar të Maqedonisë janë të ulëta. Një nivel pak më i lartë i rrezikut është regjistruar ke pjesëmarrja e kredive me probleme, pasi një e katërta e aktiveve të bankave janë në shportën e kuqe. Megjithatë, niveli i përgjithshëm i rrezikut të kredisë nuk është i lartë duke analizuar dy treguesit e zgjedhur, dhe gjithashtu trendi i tyre po përmirësohet.

Analizuar sipas treguesve, treguesi i aftësisë paguese tregon përmirësim mesatar në sjelljen me kalimin e kohës, gjegjësisht përqindja e mjeteve për tremujorin e katërt të vitit 2017, shënon një përmirësim në krahasim me vlerat e mëparshme, për dallim nga



tremujori i katërt i vitit 2015 dhe tremujori i katërt i vitit 2016, kur shportën "më të keqe" e përbënin një e treta e totalit të aktiveve të sistemit bankar. Krahasuar me treguesit për BE-në¹⁰, në tremujorin e dytë të 2017, në shportën "më të keqe" për këtë tregues kanë qenë 9.8% e totalit të aktiveve të bankës, ndërsa trendi i përmirësimit është i njëjtë si tek ne. Në treguesin e totalit të detyrimeve në raport me kapitalin dhe rezervat (ang. debt-to-equity ratio) ka një ndryshim shumë të vogël në përqindjen e mjetet që takon në shportën "më të keqe" me kalimin e kohës, por kjo përqindje është tashmë shumë e ulët dhe nuk përbën rrezik për sistemin bankar. Në bankat e BE-së, vërehet përmirësim i këtij treguesi me kalimin e kohës, por në shportën "më të keqe" në tremujorin e dytë të vitit 2017 ende llogariten pothuajse gjysma e aktiveve të sistemit bankar (47.4%).

Në treguesit e tjerë, ngjyra e gjelbër e prirjes tregon përmirësimin e sjelljes së këtyre treguesve, që do të thotë një përqindje në rritje e totalit të aktiveve bën pjesë te shportat më të mira (e verdha apo e gjelbërta). Krahasuar me treguesit për BE-në, ke treguesi i kredive me probleme në raport me përbruto-kreditë ka hapësirë për përmirësim të mëtejshëm, ndërsa në tremujorin e dytë të vitit 2017 shportën "më të keqe" e përbëjnë 12.7% të mjetet të bankave, ndërkohë që tek ne përbëjnë 25.3% në tremujorin e katërt të vitit 2017. Kështu, rezervimet e vendosura mënjanë për kreditë me probleme ndaj totalit të kredive me probleme në Maqedoni nuk janë më të vogla se 55%, ndërsa në BE 38.3% të aseteve të bankave janë në shportën "më të keqe", ku vlera e treguesit është më e vogël se 40%. Treguesit e profitabilitetit janë përmirësuar në krahasim me ato të BE-së, si dhe raporti i kredive dhe depozitave (ang. loan-to-deposit ratio) tregon se shumica e mjetet është e përqendruar në shportën "më të mire" dhe asnjë bankë nuk ka vlerë për këtë tregues më të madhe se 150%.

¹⁰ Treguesit e BE-së, të përdorur për analizë krahasuese janë marrë nga „EBA – Risk Dashboard Data as of Q2 2017”.




1. Rreziku i kredisë

Në vitin 2017, nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme në nivelin e rrezikut të kredisë në sistemin bankar, edhe pse është vërejtur realizimi i rrezikut të disa klientëve më të mëdhenj të korporatave në banka. Gjithsej kreditë me probleme të sistemit bankar janë rritur për 2.0%, por kjo rritje nuk është reflektuar në pjesëmarrjen e kredive me probleme ndaj totalit të kredisë, që është zvogëluar për 0.2 pikë përqindjeje dhe në fund të vitit 2017 është 6.3%. Sipas sektorëve, rreziku më i rëndësishëm i kreditit për bankat buron nga sektori i korporatave, shkalla e të cilit për kreditë me probleme¹¹ më 31.12.2017 është 10% dhe është më e lartë në krahasim me vitin 2016. Në rritjen e saj ka kontribuar rritja më e dukshme e kredive me probleme në krahasim me rritjen e huadhënies bankare në këtë segment të tregut të kredive. Rreziku i kredisë nga investimet e bankave për ekonomitë familjare është i ulët, shkalla e të cilave për kreditë me probleme u reduktua në nivelin më të ulët historik prej 2.4%. Bankat kanë kapacitet të mirë për trajtimin e rrezikut të kredisë, kryesisht të kredive me probleme. Rregullimi dhe mbikëqyrja e kujdesshme, por edhe qasja e kujdesshme e bankave gjatë matjes së rrezikut të kredisë mundësojnë mbulim të lartë të kredive me probleme me korrigjim të vlerës së ndarë dhe minimizim të rreziqeve për aftësinë paguese të bankave nga mosshlyerja eventuale e plotë e këtyre kredive.

Grafik 10

Rritja vjetore e kredive me probleme e subjekteve jofinanciare në milionë denarë në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Në përputhje me rregulloren, duke filluar nga 1.1.2016, bankat janë të detyruara në bazë të rregullt të i çregjistrojnë të gjitha kërkesat që janë plotësisht të rezervuara për më shumë se dy vjet. Çregjistrimi më i madh mbi këtë bazë është bërë në qershor të vitit 2016.

Në vitin 2017, Banka popullore ka hartuar një propozim-strategji për të inkurajuar trajtimin dhe përmirësimin e menaxhimit të kredive me probleme. Në këtë strategji e cila do të zbatohet në nivel të më shumë institucioneve në vend, propozohen ndryshime ose sqarime në rregullore në fushën e zbatimit, vlerësimit, taksave, çregjistrimeve, mbikëqyrjes, si dhe masa dhe aktivitete për përmirësimin e qarkullimit me arkëtimet me probleme.

1.1 Realizimi i riskut të kredisë në bilancet e bankave


Totali i kredive me probleme të sistemit bankar janë rritur për 2% në vitin 2017. Rritja e kredive me probleme ishte kryesisht e pranishme në kompanitë jofinanciare, kredive me probleme e të cilave janë rritur për 3.8%. Kjo rritje është rezultat i përkeqësimit të aftësisë së kredisë të disa klientëve më të mëdhenj nga veprimtaritë e

¹¹ Shkalla e kredive me probleme është pjesëmarrja e kredive me probleme në totalin e kredive.




“prodhimit të metaleve, makinave, veglave dhe pajisjeve”, “Informacionit dhe Komunikimit”, “industria ushqimore” dhe “industri të tjera të përpunimit”. Rritja është zbutur pjesërisht në tremujorin e tretë të vitit, për shkak të “shlyerjeve” të arkëtimeve me probleme të caktuara, duke marrë sigurinë e tyre¹².

Grafik 11
Rritja vjetore e kredive me probleme të aktiviteteve individuale të kompanive jofinanciare




Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Grafik 12
Rritja vjetore e kredive me probleme të produkteve të veçanta të kredisë për ekonomitë familjare



Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Grafik 13
Struktura e kredive konsumatore sipas llojit të sigurisë në përqindje



Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Në ekonomitë familjare, rritja e kredive me probleme ishte e moderuar dhe është 1.4%. Kjo rritje është tërësisht rezultat i kredive me probleme të konsumit (ata janë më të larta për 8.1%), që është tregues i një realizim të pjesshëm të rrezikut nga rritja e shpejtë dhe kushte të lehtësuara për kreditimin e konsumatorit në periudhën e kaluarën (kryesisht, normat më të ulëta të interesit, afateve më të gjata për shlyerjen e kredive¹³ dhe kërkesat më liberale për sigurimin¹⁴). Rritja e kredive konsumatore nuk lejoji që rritja e kredive me probleme të


¹² Prona e marrë mbi posedim rrjedh nga një kompani jofinanciare nga veprimtaria “ndërtimtari” dhe kompani të tjera më të vogla jofinanciare të lidhura me të.

¹³ Kah fundi i vitit 2015, Banka popullore paraqiti një kërkesë më të madhe për kapitale për kreditë konsumatore me maturim fillestar të barabartë ose më të gjatë se tetë vjet. Masa synonte të kufizojë rreziqet duke kontribuar në një ngadalësim të rritjes së shpejtë të huave konsumatore afatgjatë ose në mbulimin e tyre më të lartë me kapital.

¹⁴ Më 31.12.2017, 37% e totalit të kredive konsumatore janë pa kolateral (22% në vitin 2013).




Grafik 14
Norma e kredive me probleme për ekonomitë familjare në përqindje



Burimi: Regjistri i Kredive të Bankës Popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Grafik 15
Norma e kredive me probleme të subjekteve jofinanciare në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Në përputhje me rregulloren, bankat ishin të detyruara në periudhën 1.1.-30.6.2016, të shlyejnë huatë me probleme që ishin të rezervuara plotësisht për më shumë se dy vjet, dhe të vazhdonin me një praktikë të tillë për të gjitha huatë që do të përmbushnin këtë kusht. Kështu, në vitin 2016, janë shlyer 13 miliardë denarë ose rreth gjysma e totalit të kredive me probleme. Shlyerjet pasuese mbi këtë bazë janë me një sasi më të vogël, efekti i të cilave në analizën krahasuese të dhjetorit 2017-dhjetor 2016 është e parëndësishme. Rreth 80% e kredive të shlyera janë në sektorin e korporatave.

konsumit¹⁵ të ndikojë në lartësinë e normës së kredive me probleme për këtë produkt kreditor¹⁶.

Norma e kredive me probleme për ekonomitë familjare është e ulët (2.4%) dhe ka shënuar rrënie krahasuar me vitin paraprak, andaj u reduktua në nivelin historikisht më të ulët. Kjo normë gjithashtu shënon rrënie edhe në produktet e veçanta të huadhënies¹⁷, të cilat, në kushte të një disipline solide në mbledhjen e kredive ekzistuese, janë gjithashtu për shkak të rritjes së volumit të huadhënies së re¹⁸.

Pjesëmarrja e kredive me probleme në totalin e kredive u zvogëlua për 0.3 pikë përqindjeje në vitin 2017 dhe zbriti në nivelin më të ulët¹⁹ (6.3%). Në portofolin e kompanive jofinanciare, norma e kredive me probleme regjistroi një rritje minimale prej 0.1 pikë përqindjeje dhe në fund të vitit 2017 ishte 10.0%.

Sipas veprimtarive të veçanta, norma e kredive me probleme është më e larta për klientët e veprimtarisë "industriale", "ndërtimtarisë dhe veprimtarisë lidhur me pasuri të paluajtshme" dhe "tregtisë me shumicë dhe pakicë". Në vitin 2017, vetëm në ekspozimin kreditor të veprimtarisë "industriale"²⁰

¹⁵ Kreditë konsumatore gjithsej u rritën për 11.2% (ose për 7,539 milionë denarë) ndërsa kreditë konsumatore me probleme për 8.1% (ose për 139 milionë denarë).

¹⁶ Norma e kredive konsumatore me probleme ka mbetur e pandryshuar në krahasim me vitin e kaluar, dhe është 2.5%.

¹⁷ Në kreditë e automobilave kjo normë u ul për 6.6 pikë përqindjeje dhe u zvogëlua në 3.8% (ndërsa më 30.9.2017 arriti nivelin rekord më të ulët prej 2.6%), që prej vite më parë, norma e kredive me probleme ishte më e larta pikërisht për këtë produkt kredie. Domethënë, në disa vitet e fundit ka pasur një trend të zhdukjes së këtij produkti kredie në bilanci të bankave dhe "pastrim" i portofolit të kredive me probleme.

¹⁸ Në kreditë e shtëpive dhe kredive të tjera.


¹⁹ Vetëm në fund të shkurtit të vitit 2017, pjesa e kredive me probleme në totalin e kredive ishte pak më e ulët dhe arriti në 6.2%.

²⁰ Ekspozimi kreditor ndaj klientëve të veprimtarisë "industriale" merr pjesë me 21.5% në ekspozimin total kreditor ndaj kompanive jofinanciare, por kreditë me probleme për klientët e kësaj veprimtarie kanë pothuajse dyfish më shumë pjesëmarrje, përkatësisht përbëjnë 40.1% të totalit të kredive me probleme të kompanive jofinanciare.




Grafik 16
Norma e kredive me probleme të kompanive jofinanciare në përqindje

Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.



Burimi: Regjistri i Kredive të Bankës Popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Grafik 17
Veprimtaria "industriale", ndryshimi vjetor i totalit (lart) dhe kredive me probleme (në mes) dhe dinamika e treguesve për cilësinë e ekspozimit të kredisë (poshtë) në milionë denarë në përqindje




Burimi: Regjistri i Kredive të Bankës Popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

vërehet një rritje më e konsiderueshme në normën e kredive me probleme (për 4.6 pikë përqindje), që rezultojn nga rritja e ndjeshme e kredive me probleme (për 35.4%, në krahasim me zvogëlimin e tyre për 40.7% në vitin paraprak), duke ulur njëkohësisht totalin e kredive për klientët në këtë veprimtari (për 2.7%). Rritja e të ardhurave të rrezikut të kredisë nga veprimtaria "industri" është një pasqyrim i trendeve të pafavorshme në industrinë e prodhimit që shkaktojnë rënie në volumin e prodhimit industrial dhe një rënie korresponduese në inventaret e mallrave të gatshme gjatë shfrytëzimit mesatar më të ulët të kapaciteteve prodhuese. Niveli mesatar i rrezikut të kësaj veprimtarie është duke u përmirësuar, që rezultojn nga reduktimi i ekspozimit ndaj kësaj veprimtarie për shkak të një "shlyerjeje" të pjesshme të arkëtimeve me probleme nga një klient më i madh duke marrë pronën e vendosur si kolateral për këto arkëtime dhe shlyerje të arkëtimeve nga konsumatori tjetër më i madh, me një rritje të moderuar të rezervave të alokuara. Megjithatë, perceptimet e favorshme të situatës ekonomike të subjekteve afariste, sigurimi i prodhimit me porosi dhe pritjet për rritjen e vëllimit të prodhimit dhe rritjes së çmimit mesatar të shitjes së mallrave të gatshme²¹ pritjet të ndikojë pozitivisht në performancën e ndërmarrjeve në këtë veprimtari, e cila do duhej reflektuar, përkatësisht, me përmirësimin e aftësisë së tyre kreditore dhe rregullsinë në shlyerjen e detyrimeve.

²¹ Burimi: Anketë mbi tendencat afariste në industrinë prodhuese për periudhën janar-dhjetor 2017.



Grafik 18
Veprimtaria “ndërtimtari dhe veprimtari lidhur me pasuri të paluajtshme”, ndryshime vjetore të kredive gjithsejt (lart) dhe kredive me probleme (në mes) dhe dinamika e treguesve për cilësinë e ekspozimit të kredisë (poshtë)



Burimi: Regjistri i Kredive të Bankës Popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Uljen e normës së kredive me probleme në “**ndërtimtari dhe veprimtari lidhur me pasuri të paluajtshme**” (për 3.5 pikë përqindje) është për shkak të “shlyerjes” të sipërpërmendur të arkëtimeve me probleme duke marrë pronën e vendosur si kolateral për kërkesat e tilla. Kështu, ekspozimi kreditor ndaj kësaj veprimtarie nuk ka më normën më të lartë të kredive me probleme, i cili në periudhë të caktuara tejkalon edhe 20%. Niveli mesatar i rrezikut të sektorit të ndërtimtarisë është përmirësuar si rezultat i rritjes së vëllimit të kreditimit të klientëve ekzistues në këtë veprimtari, me një rritje të njëkohshme të moderuar në korigjimin e vlerës së alokuar. Megjithatë, aktiviteti në ndërtimtari shënoni ndryshime rënëse pas disa vitesh të rritjes konstante (kryesisht për shkak të rënies së investimeve infrastrukturore publike), duke treguar në një rritje të mundshme të nivelit të rrezikut të kredisë nga kjo veprimtari.


Një ulje e konsiderueshme në normën e kredive me probleme (prej 0.5 pikë përqindje) është vërejtur edhe në ekspozimet kreditore ndaj tregtisë me shumicë dhe pakicë, e cila është e lidhur me vlerësimet e favorshme të gjendjes aktuale afariste dhe financiare të shoqërive tregtare, reduktimit të rezervave dhe çmimeve të shitjes, si dhe pritjet për rritje të porosive, gjatë rritjes së vlerës së qarkullimit në tregtinë me shumicë²². Zhvendosja e favorshme në normën e kredive me probleme në tregti është e lidhur me disiplinën e përmirësuar në kryerjen e obligimeve, gjegjësisht kalimin nga statusi kredi me probleme në të rregullt të disa klientëve të kësaj veprimtarie.

²² Burimi: Anketë mbi tendencat afariste të tregtisë me pakicë, në tremujorin e parë, të dytë, të tretë dhe të katërt të vitit 2017.



Grafik 19

Krahasimi në mes të përqendrimit të portofolit total të kredive me probleme të subjekteve jofinanciare, sipas banka individuale në përqindje




Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Shënim: Vija e zezë e tregon trendin.

Grafik 20

Mbulimi i kredive me probleme dhe pjesëmarrja e kredive neto me probleme në fondet vetanake të bankave në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Përqendrimi i portofolit të kredive me probleme është i lartë, duke pasur parasysh se dhjetë ekspozimeve më të mëdha të kredive me probleme²³ përbëjnë 60.9% të ekspozimeve totale të kredive me probleme të sistemit bankar. Kjo do të thotë që ekspozimet e kredive me probleme për bankat janë kryesisht për shkak të disa klientëve më të mëdhenj. Sipas bankave individuale, pjesëmarrja e dhjetë ekspozimeve më të mëdha të kredive me probleme në ekspozimin total të kredisë lëviz në interval prej 0% deri në të larta prej 90.9%. Rezervimi solid i ekspozimeve më të mëdha të kredive me probleme të bankave (85.2%) i zvogëlon humbjet e papritura të këtyre ekspozimeve, dhe rrjedhimisht efektin e mundshëm negativ në mjetet vetanake.

1.2 Kapaciteti i bankave për menaxhim me rrezikun kreditor


Mbulimi i kredive me probleme me korigjimin e vlerës së alokuar shënon rënie, por akoma mbetet i lartë, që i kufizon efektet negative të një mos pagese të mundshme të plotë të kredive me probleme. Domethënë, pjesa e parazervuar e kredive me probleme përfshinë vetëm 7.9% të kapitalit vetanak të sistemit bankar prej të cilave do të mbuloheshin humbjet e papritura gjatë një ngjarjeje hipotetike ekstreme të mos pagesës së plotë të këtyre kredive. Në një supozim i tillë ekstrem, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit bankar do të ullej për vetëm 1.2 pikë përqindje (pothuajse identike si në vitin paraprak).

²³ Secila prej këtyre dhjetë ekspozimeve përfshinë ekspozimin ndaj një klienti të caktuar, duke përfshirë edhe personat e lidhur me të.



Grafik 21


Normat vjetore të mospagesës së ekspozimit të kredisë me status të rregullt, sipas veprimtarive individuale të kompanive jofinanciare në përqindje



Burimi: Regjistri i Kredive të Bankës Popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Grafik 22

Normat vjetore e mospagesës së ekspozimit të kredisë me status të rregullt dhe niveli mesatar i rrezikut të kredive të rregullta, sipas produkteve kreditore individuale të ekonomive familjare në përqindje



Burimi: Regjistri i Kredive të Bankës Popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

1.3 Burime të tjera të mundshme të realizimit të rrezikut të kredisë

Në vitin 2017, norma vjetore e realizuar e mos pagesës së ekspozimit kreditor me status të rregullt²⁴ është 1.8% (e njëjtë si në vitin paraprak) dhe është më e ulët në krahasim me nivelin mesatar të rrezikut të kredive të rregullta për entitetet jo financiare (2.3%), të përcaktuara nga bankat. Kjo tregon se bankat janë më të kujdesshme dhe kanë siguruar tepriçë pak më të lartë të kredive të rregullta në krahasim me atë që tregon realizimi i normës vjetore të mos pagesës së këtyre llogarive të arkëtueshme.

Sipas aktiviteteve të caktuara, normat vjetore të mos pagesës kryesisht kanë shënuar përmirësim, me përjashtim të përkeqësimit në veprimtarinë "industrial", që rrjedh nga kalimi në status kredi me probleme të disa klientëve të mëdhenj të angazhuar në prodhimin e metaleve dhe prodhimin të produkteve të duhanit, si dhe disa klientëve më të vegjël nga "industria tjetër e përpunimit"²⁵. Pavarësisht përkeqësimit të normës vjetore të mos pagesës në këtë veprimtari, korrigjimi i vlerës së kredive të rregullta nga industria shënon rënie, duke treguar në perceptim më të dobët të bankave për realizimin e rrezikut të kredisë nga kreditë në këtë veprimtari²⁶. Njëkohësisht, korrigjimi i vlerës për kreditë e rregullta të klientëve të angazhuar në veprimtarinë "ndërtimtari dhe veprimtari që lidhen me pasuri të patundshme", shënoi rritje vjetore, pavarësisht nga përmirësimi i normës vjetore të mos pagesës në këtë veprimtari.

²⁴ Norma vjetore e mospagesës së ekspozimit kreditor llogaritet si përqindje e shumës së ekspozimit të kredisë me status të rregullt që për një periudhë njëvjeçare ka marrë një status të kredisë me probleme.


²⁵ Shkalla vjetore e mos pagesës ishte 8.8% dhe 9.9% për veprimtaritë "prodhimi i metaleve, makinave, mjeteve dhe pajisjeve" (1.1% më 31.12.2016) dhe "industria tjetër përpunuese" (0.9% më 31.12.2016), respektivisht.

²⁶ "Industria" përfshinë 24.4% të totalit të kredive të miratuara kompanive jo financiare, 22.6% të rregullta dhe 40.1% të kredive me probleme.



Grafik 23


Pjesëmarrja e kredive të rregullta të pasigurta në totalin e kredive të rregullta, sipas veprimtarive individuale dhe produkteve të kredisë në përqindje



Burimi: Regjistri i Kredive të Bankës Popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Grafik 24

Treguesit e nivelit të përqendrimit të ekspozimit ndaj subjekteve jofinanciare në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Përkrah mbulesës së duhur të kredive të rregullta me korrighim të vlerës së ndarë, e lartë është edhe pjesëmarrja e kredive të rregullta në të cilat është vendosur siguri (85.9% e totalit të kredive të rregullta të subjekteve jo-financiare), që është burim dytësor i pagesës, në rast të dështimit eventual të huamarrësit për të i përmbushur detyrimet sipas marrëveshjes së huas.

Pjesëmarrja e lartë e kredive të siguruara është kryesisht karakteristikë e kërkesave të rregullta të kompanive jo financiare (98.3%). Në ekonomitë familjare, pjesëmarrja e kredive të rregullta të siguruara ndaj totalit të kredive të rregullta është dukshëm më e ulët dhe është 73.1%, që rrjedh nga kreditë bazuar në tejkalinim e llogarive rrjedhëse, kartat e kreditit dhe kredi konsumatore²⁷ (prej të cilave gati gjysma janë pa siguri). Megjithatë, në marrëveshjet e kredisë aplikohet mjaft e ashtuquajtura klauzolë zbatimi²⁸ e cila, në rast të mos plotësimit të detyrimeve nga marrëveshja e kredisë nga ana e klientëve, mundëson që bankat të kryejnë pagesat e kredive nga prona e huamarrësve²⁹.

Përqendrimi i portofolit të kredive të bankave nuk është i lartë parë nëpërmjet treguesit për pjesëmarrjen e ekspozimeve të mëdha³⁰ të fondeve vetanake të bankave, të cilat përbëjnë 51.9% dhe ka një prirje të theksuar rënëse në dy vitet e fundit (80,8% më 31.12.2015) për shkak të rënies së ekspozimeve të mëdha ndaj subjekteve jo financiare. Sipas bankave individuale ky tregues është shumë më i vogël se maksimumi i përcaktuar

²⁷ Pjesëmarrja në totalin e kredive të rregullta të pasiguruara të konsumit është rritur në krahasim me vitin e kaluar dhe arriti në 36.7%, por është më e ulët se në tremujorin e tretë të vitit 2017, kur kjo pjesëmarrje për herë të parë ka tejkalluar 40%.


²⁸ Banka popullore nuk ka të dhëna mbi sasinë e kredive kontratat e të cilëve përmbajnë një klauzolë zbatimi të tillë.

²⁹ Sipas Ligjit për zbatim ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 72/16) dhe Ligji për noterinë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 72/16).

³⁰ Ekspozim i madh ndaj një personi ose personave të lidhur me të është ekspozimi i barabartë me ose më i madhe se 10% e fondeve vetanake të bankës.




Grafik 25
Dinamika dhe rritja vjetore e totalit të kredive të ristrukturuara dhe të prolonguara të subjekteve jofinanciare



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Grafik 26
Dinamika e kredive të prolonguara dhe treguesit strukturorë (lart) dhe niveli mesatar i rrezikut të kredive të prolonguara të subjektet jofinanciare dhe sektorët individual (posht) në milionë denarë dhe në përqindje (lart), në përqindje (posht)



Burimi: Regjistri i Kredive të Bankës Popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

ligjërisht³¹. Megjithatë ai duhet të monitorohet me kujdes sidomos në rastin kur në mënyrë të konsiderueshme tejkalon fondet vetanake të bankës³², për shkak se raporti më i lartë me fondet vetanake të bankave e rrit efektin negativ që mund ta ketë realizimi i rrezikut të këtyre ekspozimeve dhe paaftësia për pagesën e tyre mbi burimet vetanake. Prandaj, veçanërisht e rëndësishme është cilësia e kreditit të këtyre ekspozimeve, të cilat në nivel agregat, nuk tregojnë një rrezik të lartë për shkak se shumica e ekspozimeve klasifikohen në kategoritë e rrezikut "A" dhe "B".

Dhjetë ekspozimet më të mëdha të bankave për entitetet jo-financiare³³ përbëjnë 95.8% të fondeve vetanake të bankave, që është tregues i një niveli të moderuar të rrezikut të përqendrimit. Por, sipas bankave individuale, kjo pjesëmarrje lëviz në interval prej 5.8% deri në të larta prej 175.0%³⁴. Në nivel agregat, këto ekspozime kanë rrezik të ulët (kryesisht në kategoritë e rrezikut "A" dhe "B"), megjithatë, në kuadër të ekspozimeve më të mëdha vërehen ekspozimet individuale me rrezik më të lartë.

Vazhdimi i afatit të maturimit të kontraktuar të kredive është një praktikë e zakonshme e bankave, në rastet kur gjendja financiare e klientit nuk është e dëmtuar. Megjithatë,

³¹ Sipas rregulloreve shumica e përgjithshme e ekspozimeve të mëdha nuk duhet të kalojë tetë herë shumën e fondeve vetanake.

³² Sipas bankave individuale, pjesëmarrja e ekspozimeve të mëdha të subjekteve jofinanciare lëviz në interval nga 0% deri në 133.6%, ku pjesëmarrjet më të larta janë tregues i nivelit të konsiderueshëm të përqendrimit të rrezikut, të cilat banka zakonisht e mbulon me një sasi të caktuar të fondeve vetanake.



³³ Ekspozimi i përgjithshëm ndaj një personi dhe personave të lidhur me të nuk duhet të tejkalojë 25% të fondeve vetanake të bankës.

³⁴ Pragu i sipërm i këtij intervali të pjesëmarrjeve të dhjetë ekspozimeve më të mëdha në fondeve vetanake të bankës përkatëse është tregues i një niveli më të rëndësishëm të rrezikut të përqendrimit, të cilin banka zakonisht e mbulon me një sasi të caktuar të fondeve vetanake.



Grafik 27

Norma e kredive me probleme për portofolion e kredive të prolonguara (lart) dhe pjesëmarrja e kredive të rregullta të prolonguara në totalin e kredive me probleme (posht), sipas veprimtarive të veçanta të shoqërive jofinanciare në përqindje



Burimi: Regjistri i Kredive të Bankës Popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

vazhdimet e shumta të afatit, mund të fshehin cilësinë reale të kredive, por gjithashtu të jenë një tregues i rrezikut më të lartë të kredisë, gjegjësisht për përkeqësimin e pozicionit financiar të konsumatorit e cila, sipas rregullores, duhet të ketë trajtim të ristrukturimit dhe të ndahet korrigjim i vlerës më i madh, po ndoshta edhe të marrin statusin kredi me probleme.

Në fund të vitit 2017, kreditë e prolonguara përfaqësojnë 10.6% të gjithsej kredive për subjektet jo financiare. Për ekonomitë familjare kjo pjesëmarrje për herë të parë ka arritur nivelin dyshifror (për krahasim, në vitin 2014 kjo pjesëmarrje ishte nën 1%), dhe kryesisht rrjedh nga kreditë konsumatore³⁵, prej të cilave 15.6% janë kredi të prolonguara³⁶. Gjithashtu, rritja e kredive të prolonguara tejkalon në mënyrë të konsiderueshme rritjen e totalit të kredive, si për ekonomitë familjare, ashtu dhe për kompanitë jo-financiare³⁷.

Duke pasur parasysh lëvizjet e tilla, është me rëndësi të veçantë të shihet cilësia e kredive të prolonguara. Norma e kredive me probleme për kompanitë jo-financiare të cila më parë kanë qenë të prolonguara (12.7%)³⁸ është më e lartë për 2.7 pikë përqindjeje nga kjo normë në portofolit të kredisë totale të kompanive jo-financiare, por shënon rritje mjaft më të shpejtë të (përkeqësim të cilësisë) krahasuar me totalin portofolit të korporatave³⁹. Niveli mesatar i rrezikut të kredive të prolonguara

³⁵ Në vitin 2017, kreditë e prolonguara konsumatore regjistruan një rritje vjetore prej 32.6%.

³⁶ Në vitin 2014 pjesëmarrja e kredive të prolonguar në gjithsej kreditë konsumatorë shënon 0.7%.

³⁷ Në vitin 2017, kreditë e prolonguara për ekonomitë familjare dhe kompanitë jofinanciare u rritën për 33.3% dhe 21.8% përkatësisht, ndërsa rritja e realizuar në kreditë e përgjithshme ishte 9.7% dhe 2.9%.

³⁸ Kjo normë tregon pjesëmarrjen e kredive me probleme për kompanitë jo-financiare të cila kanë qenë të prolonguara më parë në totalin e kredive të prolonguara.


³⁹ Norma e kredive me probleme të prolonguara më parë në vitin 2017 u rrit për 2.9 p.p. ndërkohë që norma e kredive me probleme ndaj totalit të portofolit të korporatave u rrit për vetëm 0.1 p.p.

Norma e zgjatura kredive me probleme që janë të prolonguar më parë është më e lartë në veprimtarinë "industriale" (32.3%).



Grafik 28

Dinamika e kredive të rregullta të ristrukturuara dhe tregues të cilësisë së tyre (lart) dhe pjesëmarrja e kredive të rregullta të ristrukturuara në totalin e kredive të ristrukturuara (në mes) dhe në totalin e kredive me probleme (posht), sipas veprimtarive të veçanta të kompanive jofinanciare në milionë denarë dhe në përqindje (lart), në përqindje (në mes dhe posht)



Burimi: Regjistri i Kredive të Bankës Popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

të rregullta për kompanitë jo-financiare është përafërsisht e njëjtë si për gjithë portofolin e rregullt të kredisë për kompanitë jo-financiare. Në ekonomitë familjare, cilësia e kredive të prolonguara është në nivel shumë më të lartë⁴⁰. Norma historike e mospagimit të kredive të rregullta të prolonguara (3.7%)⁴¹ tejkalon nivelin mesatar të rrezikut, duke treguar në rezervim të tyre më të dobët, por edhe pritje më të dobëta të bankave për realizimin e mundshëm të rreziqeve të këtyre kredive. Për më tepër, shkalla historike e mospagimit të kredive të rregullta të prolonguara është dyfish më e madhe nga portofoli i kredisë totale të rregullt dhe shënon rritje të dyfishtë në krahasim me vitin paraprak, duke treguar një probabilitet të lartë të kalimit të një pjese të këtyre të rregullta në kërkesa të kredive me probleme.

Një burim tjetër i mundshëm për realizimin e rrezikut të kredisë janë edhe lëvizjet në kreditë e ristrukturuara. Bëhet fjalë për kredi të konsumatorëve që përballen me vështirësi financiare dhe të cilët ndoshta do të kishin marrë statusin me probleme në qoftë se bankat nuk ua kanë ndryshuar kushtet e kreditimit. Në vitin 2017, kreditë e rregullta të ristrukturuara janë zvogëluar (për 14.7% ose për 732 milionë denarë)⁴², që ishte e përqendruar në kompanitë jo-financiare (të cilat gjithashtu mbizotërojnë në portofolin e kredive të ristrukturuara). Reduktimi i kredive të rregullta të ristrukturuara kryesisht rrjedhin nga tranzicioni në statusin me probleme të disa kërkesave të ristrukturuara më të mëdha⁴³, që mund të

⁴⁰ Kreditë me probleme për ekonomitë familjare, të cilat janë prolonguar më parë, përfshijnë vetëm 0.8% të totalit të kredive të prolonguara të ekonomive familjare, ndërsa rreziku mesatar i kredive të rregullta të prolonguara është shumë i ulët.


⁴¹ Shkalla e historike e mospagimit është llogaritur si një përqindje e shumës së ekspozimit të kredisë me status të rregullt e cila për një periudhë prej një viti ka marrë statusin kredi me probleme sipas të dhënave të paraqitura nga bankat për Regjistrin e Kredive të Bankës Popullore.

⁴² Kreditë e rregullta të ristrukturuara tregojnë rritje të ndjeshme prej 84.6% (ose 213 milionë denarë) veçanërisht në "ndërtimtari".

⁴³ Të klientëve nga veprimtaritë "tregtia me shumicë dhe pakicë", "informacionit dhe komunikimit" dhe "industria" (veçanërisht klientët nga veprimtaritë "industria e tekstilit dhe




Grafik 29
Struktura e kredive të ristrukturuara dy vjet më parë me gjendje të datës përkatëse në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Grafik 30
Dinamika dhe niveli mesatar i rrezikut të kredive me vonesë në shlyerjen e principalit midis 61 dhe 90 ditëve në milionë denarë në përqindje



Burimi: Regjistri i Kredive të Bankës Popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

konsiderohet si një tregues i ristrukturimit jo në kohë apo joadekuat të kërkesave. Në një pjesë më të vogël, reduktimi i kredive të rregullta të ristrukturuara është për shkak të shlyerjes së disa kredive të ristrukturuara paraprakisht⁴⁴.

Norma historike e mospagimit të kredive të rregullta të ristrukturuara (8.9%) dukshëm e tejkalon këtë normë për kreditë e rregullta totale të sektorit jo financiar, që është e pritshme duke pasur parasysh se bëhet fjalë për klientë me gjendje financiare të përkeqësuar. Gjithashtu, bankat kanë siguruar rezervim solid të kredive të rregullta të ristrukturuara (22.6%), që korrespondon me rrezikun më të lartë të këtyre kredive dhe gjasat për vështirësi të mundshme gjatë pagesës së tyre.

Suksesi i bankave në ristrukturimin e kredive, në aspekt të perceptimit në kohë të duhur të nevojës për ristrukturim dhe ndryshimit adekuat të kushteve të kredisë, vlerësohet duke monitoruar ecurinë e arritjeve të këtyre kredive dy vjet⁴⁵ pas realizimit të ristrukturimit. Kredi të ristrukturuara me sukses konsiderohen kreditë që janë paguar ose kanë një status të rregullt dy vjet pas ristrukturimit. Kështu, në fund të vitit 2017, ristrukturimi është i suksesshëm në diçka më pak se dy të tretat e ristrukturimeve të kryera gjatë vitit 2015. Përqindja e suksesit të kërkesave të ristrukturuara është dyfishuar në të dy segmentet e sektorit jo financiar⁴⁶, gjë që tregon një përmirësim të

prodhimin e veshjeve dhe mbathjeve” dhe “industria kimike, prodhimin e materialeve të ndërtimit, të prodhimit dhe të përpunimit karburanteve”).

⁴⁴ Paga e kredive të rregullta të ristrukturuara ka të bëjë me kërkesat nga disa klientë nga veprimtaritë “veprimtari të lidhura me pasuri të patundshme” dhe tregti me shumicë dhe pakicë”.


⁴⁵ Në pajtueshmëri me standardet për realizimin e ristrukturimit dhe menaxhimit me kërkesat e ristrukturuara të vendosur në kornizë ndërkombëtare dhe sidomos në BE, konsiderohet se periudha prej dy vjetësh është e mjaftueshme për të perceptuar efektet e këtij aktiviteti të bankave (të ashtuquajturat periudha e provës).

⁴⁶ Në fund të vitit 2017, 61.8% dhe 68.4% të ristrukturimeve të kryera dy vjet më parë për kërkesat nga kompanitë jofinanciare dhe ekonomitë familjare, respektivisht, konsiderohen si të suksesshme (36.2% dhe 35.1% në fund të vitit 2016, për ristrukturimet gjatë vitit 2014).



Grafik 31

Dinamika e kredive me pagesë të vetme të principalit (PVP) dhe tregues për strukturën dhe cilësinë e tyre në milionë denarë në përqindje



Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

ndjeshëm në cilësinë e këtij aktiviteti të bankave. Përfaqësimi më i madh i kredive të paguara si dhe atyre ku klientët rregullisht shlyejnë detyrimet të maturuara në krahasim me ristrukturimet e kryera gjatë vitit 2014 tregon **rritje në suksesin e ristrukturimit** dhe përmirësimin e kapacitetit të bankave në zbatimin e këtij aktiviteti.

Një "burim" tjetër i mundshëm i kredive të reja me probleme janë kërkesat e bankave në të cilat periudha e vonesës në shlyerjen e principalit është midis 61 dhe 90 ditëve (praktikisht janë në kufi të marrjes së statusit me probleme). Këto kërkesa përbëjnë 1.0% të totalit të kredive të rregullta, dhe niveli mesatar i tyre i rrezikut është 12.4%. Gjithashtu, ato u zvogëluan në vitin 2017, për 7.1% ose 218 milionë denarë, që në tërësi rrjedh prej kompanive jo financiare. Por, ky zhvillim në dukje pozitiv nuk lidhet me pagesën, por me kalimin në statusin me probleme të një konsumatori më të madh që merret me prodhimin e metaleve, dhe në fund të vitit 2016 është vonuar në shlyerjen e principalit në intervalin e caktuar. Pozitiv është fakti se në janar të vitit 2018, vetëm 1.7% e kredive të maturuara në mes 61 dhe 90 ditëve kanë marrë status me probleme, gjë që tregon një grumbullim solid të pjesës së maturuar prej 61 deri në 90 ditë. Në ekonomitë familjare⁴⁷, kjo përqindje është më e lartë dhe është 4.8%⁴⁸.

Burim i mundshëm i humbjeve të papritura të kreditit, për shkak të rrezikut inherent më të lartë që ata kanë, paraqesin edhe kreditë me pagesë të vetme të principalit. Te këto kredi bankat vlerësojnë rregullsinë e klientëve në shlyerjen e detyrimeve, vetëm në bazë të pagesës së interesit, gjegjësisht pamundësia eventuale për të shlyer


⁴⁷ Pjesa më e madhe e kredive me probleme të transferuara i referohen kredive konsumatore.

⁴⁸ Në kompanitë jofinanciare, përqindja e kalimeve të këtyre kredive në status me probleme është në nivel më të ulët në raport me sektorin e përgjithshëm jofinanciar, dhe përbën 1.2%.



Grafik 32

Pjesëmarrja e kredive me pagesë të vetme të principalit (PVP) në totalin e kredive (lart), të kredive me probleme me PVP në totalin e kredive me probleme (në mes) dhe kredive me probleme me PVP në totalin e kredive me PVP (posht), sipas veprimtarive të caktuara të kompanive jofinanciare në përqindje



Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

detyrimet vërehet me maturimin e principalit. Në fund të vitit 2017, rreth një e treta e totalit të kredive të shoqërive jo financiare kanë një klauzolë për pagesë të vetme të principalit, që nuk është e papërfillshme⁴⁹. Sipas normës së kredive me probleme (që është 8.7% dhe rritet vetëm për 0.8 p.p.), kreditë me shlyerje të vetme e principalit⁵⁰ kanë një cilësi më të mirë krahasuar me kreditë e prolonguara dhe të ristrukturuara. Njëkohësisht, niveli mesatar i rrezikut të kredive të rregullta për kompanitë jo-financiare me pagesë të vetme të principalit është 2.9% (niveli mesatar i rrezikut të portofolit të kredisë totale të përbërë nga kompanitë jo-financiare është 3.5%). Norma historike e pa arkëtueshme e këtyre kredive (1.4%) është më e ulët në krahasim me portofolin e kredisë së rregullt totale dhe shënon përmirësim krahasuar me vitin e mëparshëm kur këto dy norma ishin në të njëjtin nivel (1.8%). Niveli mesatar dyfish më i lartë i rrezikut të kredive të rregullta me shlyerje të vetme e principalit të normave historike të pa arkëtueshme tregon se bankat kanë bërë korrigjim më të lartë të vlerës në krahasim me humbjet e pritshme analizuar përmes normës historike të mospagesës së këtyre kërkesave. Këto zhvillime konfirmojnë rrezikun e ulët të kredive të rregullta me shlyerje të vetme të principalit, dhe kështu edhe probabiliteti i ulët i konvertimit të tyre të plotë në status me probleme, edhe pse për disa pretendime më rrishtme ky supozim konsiderohet i realizueshëm.


⁴⁹ Sipas veprimtarive të veçanta, kjo përqindje është edhe më e lartë se totali në "industri" (38.4%) dhe "tregtia me shumicë dhe pakicë" (41.9%).

⁵⁰ Kjo normë tregon pjesëmarrjen e kredive me probleme me pagesë të vetme të principalit në totalin e kredive me pagesë të vetme të principalit.



Grafik 33


Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit sipas veprimtarive të veçanta dhe produktet e kreditit, pas simulimit të parë (lart) dhe të dytë (poshtë) për të dy sektorët së bashku në përqindje



Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Grafik 34

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit para dhe pas tre goditjeve të kombinuara, sipas veprimtarive të veçanta të kompanive jofinanciare në përqindje



Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

1.4 Stres-testimi i rezistencës së sistemit bankar për të rritur rrezikun e kredisë

Rezultatet e stres-testimit e konfirmojnë rezistencën e sistemit bankar ndaj goditjeve të simuluar⁵¹ dhe tregojnë përmirësim në krahasim me vitin e kaluar. Kjo është për shkak të mjaftueshmërisë më të lartë së kapitalit të sistemit bankar përpara realizimit të simulimit, por edhe ndaj ndjeshmërisë më pak të shprehur të disa bankave ndaj goditjeve të supozuara. Në të njëjtën kohë, mjaftueshmëria e kapitalit të sistemit bankar nuk ulet nën 8% në asnjë nga simulimet, dhe vetëm një bankë percepton një nevojë hipotetike për rikapitalizim, por vetëm në simulimin e dytë ekstrem. Sipas veprimtarive të caktuara, efekt më të madh në normën e mjaftueshmërisë së kapitalit ka përkeqësimi i simuluar i aftësisë kreditore të konsumatorëve nga veprimtaria “industria” dhe “tregti me shumicë dhe pakicë”.

Rezistenca e sistemit bankar është shqyrtuar përmes zbatimit të simulimit jashtëzakonisht ekstrem i cila është i bazuar në një kombinim të goditjeve hipotetike të përkeqësimit të cilësisë së portofolit të kredisë⁵², ku shkalla e mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit bankar është ulur për 1.9 pikë përqindjeje (pothuajse identike si dhe në vitin paraprak). Edhe në këtë simulim, ulje më të mëdha në normën e mjaftueshmërisë së kapitalit janë regjistruar në përkeqësimin e supozuar në aftësinë

⁵¹ Me qëllim që të shqyrtohet ndjeshmëria e sistemit bankar në përkeqësimin e cilësisë së segmenteve të caktuara të portofolit të kredive bankare, realizohen simulime të një tranzicioni hipotetik të 10% (simulimi i parë) dhe 30% (simulimi i dytë) të ekspozimit të kredisë të kompanive jofinanciare (sipas veprimtarisë), të ekonomive familjare (sipas produkteve të kreditit) dhe të dy sektorëve së bashku, nga ato ekzistuese, në dy kategoritë e ardhshme me rrezik më të lartë.

⁵² 1. Të gjitha kreditë me probleme ndaj subjekteve jofinanciare janë krejtësisht të papagueshme, 2. ekspozimi total i kredisë të rregullt të ristrukturuar imerr statusin me probleme dhe 3. bankat po zbatojnë ristrukturimin e ri të pjesës së rregullt të portofolit të kredisë, të cilat sipas vëllimit korrespondojnë me shumën e ekspozimeve të ristrukturuara që kanë marrë një status me probleme.



kreditore të konsumatorëve nga veprimtaria "industria" dhe "tregti me shumicë dhe pakicë", e cila e konfirmon ndjeshmërinë jashtëzakonisht të lartë të cilësisë së portofolit të kredisë gjatë përkeqësimit të arritjeve të klientëve nga këto veprimtari.




2. Rreziku i likuiditetit

Në kushtet e stabilizimit gradual të pritjeve të subjekteve ekonomike vendore, mjetet e përgjithshme likuide të bankave në vitin 2017 vazhdojnë të rriten, por me një rritje të vogël dhe më të ngadalshme krahasuar me vitin paraprak. Rritja vjetore e mjeteve likuide ishte më e shprehur tek investimet e bankave në letrat me vlerë shtetërore vendore afatgjate dhe në bonot e thesarit, si dhe mjetet valutore afatshkurtra të bankave në bankat e huaja u rritën gjithashtu. Pavarësisht ndikimit të faktorëve të natyrës jo ekonomike, që në mënyrë të pashmangshme ndikojnë në mjedisin e përgjithshëm në të cilin veprojnë bankat, pjesëmarrja e mjeteve likuide në totalin e mjeteve të sistemit bankar vazhdon të jetë në nivel të qëndrueshëm, si dhe në nivel të kënaqur mbetet edhe mbulimi i detyrimeve afatshkurtra dhe depozitave nga familjet me mjete likuide. Në strukturën e mjeteve dhe detyrimeve të bankave sipas maturimit të tyre të mbetur, vërehet se diferenca është thelluar (më shumë në segmentin me maturim më të shkurtër, deri në shtatë ditë dhe dukshëm më pak në segmentin e maturimit nga gjashtë muaj deri në një vit). Simulimet për goditjet e kombinuara të likuiditetit, gjithashtu konfirmojnë se bankat në Republikën e Maqedonisë mbajnë një nivel të kënaqshëm të mjeteve likuide që u mundësojnë atyre një menaxhim të përshtatshëm me rrezikun e likuiditetit dhe rezistencë të kënaqshme ndaj rrjedhjeve të supozuara ekstreme të likuiditetit.

2.1 Dinamika dhe përbërja e mjeteve likuide

Grafik 35
Mjetet likuide, struktura dhe rritja
në milionë denarë dhe në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga ana e bankave.


Në fund të vitit 2017, mjetet likuide⁵³ në nivel të sistemit bankar arrijnë në 133,784 milionë denarë. Pavarësisht reduktimeve tremujore gjatë vitit 2017, në baza vjetore ato shënojnë rritje për 1,121 milionë denarë, ose për 0.8% krahasuar me vitin paraprak. Rritja vjetore e mjeteve likuide, e cila është paksa më e ngadalshme në krahasim me vitin paraprak, në pjesën më të madhe është kryesisht për shkak të rritjes së plasmaneve të bankave në letrat me vlerë shtetërore, si dhe për shkak të rritjes së mjeteve valutore afatshkurtra në bankat e huaja. Në anën tjetër, **mjetet në para (cash) dhe mjetet e bankave të plasura në bankën kombëtare** u zvogëluan (për 1,100 milionë denarë, ose

⁵³ Aktivet likuide përfshijnë: 1) paratë e gatshme dhe kërkesat e Bankës popullore, ku përfshihen paratë e gatshme në fuqi, paratë e gatshme në llogaritë e bankave në Bankën popullore, depozitat në dispozicion të Bankës popullore dhe bonot e thesarit; 2) depozitat afatshkurtra tek bankat e huaja, duke përfshirë mjetet e bankave në llogaritë e tyre korresponduese jashtë vendit; dhe 3) vlera kontabël e plasmaneve në letrat me vlerë të emetuara nga qeveritë qendrore d.m.th. letrat me vlerë shtetërore të emetuara nga Republika e Maqedonisë dhe të emetuara nga vendet e huaja. Për nevojat e analizës së rrezikut të likuiditetit, mjetet dhe detyrimet në denarë me klauzolën për valutë të huaj konsiderohen si denarë.



Grafik36

Ndryshimi vjetor i mjeteve likuide nga komponentët individualë, absolute (lart) dhe relative (poshtë) në milionë denarë dhe në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga ana e bankave.

për 1.6%), që në pjesën më të madhe kryesisht për shkak të plasmaneve të bankave në depozita në valutë të huaj në Bankën popullore, të cilat në mungesë të ankandeve të reja për depozitat në valutë të huaj, përputheshin plotësisht në tremujorin e tretë të vitit 2017 dhe u paguan nga Banka popullore⁵⁴. Kontribut të rëndësishëm në uljen e mjeteve në para dhe kërkesës së bankave nga Banka popullore në vitin 2017 kishte edhe rënia e plasmaneve të bankave në depozitat në dispozicion në Bankën popullore me afat maturimi prej shtatë ditësh⁵⁵, ndërkohë që rënia e investimeve të bankave në depozitat në dispozicion në Bankën popullore me afat maturimi brenda natës ishte dukshëm më e ulët. Investimet e bankave **në bonot e thesarit** në vitin 2017 janë më të larta (për 2,003 milionë denarë, ose për 8.7%). Ankandet e bonove të thesarit edhe gjatë vitit 2017 janë zbatuar përmes një tenderi me shumat dhe shumën e caktuar të kufizuar të ofruar, ku me ç'rast Banka popullore vazhdoi me normalizimin e politikës monetare nga dhjetori i vitit 2016⁵⁶ dhe në dy raste (janar dhe shkurt) uli normën bazë të interesit, për gjithsej 0.50 pikë përqindje, në 3.25%.

⁵⁴ Ankandet e instrumenteve për depozitat në valutë të huaj të bankave, PBRM-së e aplikoi në periudhën maj-tetor të vitit 2016. Në këtë periudhë, bankat kishin mundësi për plasimin e depozitave në valutë të huaj në BPRM-së me kushte më të favorshme sesa ato që mbizotëronin në tregjet financiare ndërkombëtare. Duke pasur parasysh maturimin e ndryshëm deri në maturim të depozitave në valutë të huaj, gjendja e tyre në gjysmën e parë të vitit 2017 gradualisht u zvogëlua dhe depozitat u përputhën tërësisht në fillim të gushtit të vitit 2017.


⁵⁵ Në bazë të Vendimit mbi depozitat në dispozicion ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/12, 18/13, 50/13, 166/13 dhe 35/15), bankat mund të plasojnë depozita në Bankën popullore çdo ditë pune me afat maturimi një dite pune dhe një herë në javë me një maturitet prej shtatë ditësh. Këto depozita plasohen pa mundësinë e tërheqjes së pjesshme ose të plotë para kohe. Normat e interesit për këto depozita gjatë gjithë vitit 2017 arritën në 0.25% për depozitat brenda natës dhe 0.5% për depozitat me afat maturimi prej shtatë ditësh dhe në mars të vitit 2018 u reduktuan në 0.15% dhe 0.3%.

⁵⁶ Në dhjetor të vitit 2016, Banka popullore uli normën e interesit për bonot e thesarit nga 4% në 3.75%.



Grafik 37

Shuma e kërkesës dhe ofertës në ankandet e bonove të thesarit të Bankës popullore në milionë denarë dhe në përqindje




Burimi: Banka popullore.

Si rrjedhojë e këtyre lëvizjeve, në strukturën e mjeteve likuide të bankave, erdhi në një rënie vjetore të pjesëmarrjes së mjeteve në para dhe plasmaneve të bankave në instrumentet e Bankës popullore (nga 51.3% në 50.1%) në llogari të rritjes së pjesëmarrjes strukturore të letrave me vlerë shtetërore (nga 24.6% në 25.3%) dhe depozitave afatshkurtra në bankat e huaja (nga 24.1% në 24.6%). Megjithatë, edhe përkundër reduktimit, mjetet në para dhe mjetet e bankave të plasuara në Bankën popullore rregullisht janë përbërësi më i shpeshtë i mjeteve likuide të bankave, ku brenda kornizave të tyre, shuma më e madhe i takon investimit në bonot e thesarit.

Grafik 38

Burimi: Banka popullore.

* Përqindjet në kllapa i referohen intervalit të kërkesave për kapital për bankat individuale, ndërsa përqindja jashtë kllapave i referohet kërkesës së kapitalit të llogaritur në nivelin e sistemit të përgjithshëm bankar.

** Shtresa mbrojtëse e kapitalit për bankat me rëndësi sistemike i referohet gjysmës së shumës që bankat duhej të plotësonin jo më vonë se 30.09.2017.




5.1. Treguesit e solventitetit dhe të kapitalizimit të sistemit bankar dhe niveli i rrezikshmërisë së aktiviteve

Grafik 66

Treguesit e solventitetit (lart) dhe normat vjetore të ndryshimit të komponentave të tyre (poshtë)

Në përqindje




Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga bankat.

Grafik 67

Niveli i levave, rrezikut dhe solventitetit të sistemit bankar

Në herë dhe në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga bankat.

Në vitin 2017, treguesit e solventitetit dhe kapitalizimit të sistemit bankar⁷³ shënuan ndryshimi rritëse. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 15.7% dhe shënoi rritje vjetore prej 0.5 pikë përqindje. Rritja e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit në vitin 2017 rrjedh nga niveli i zvogëluar të borxhit (levës), i matur si raport mes aktives dhe mjeteve vetanake, pavarësisht rritjes së nivelit të rrezikut (matur si raporti midis aktives së ponderuar sipas rreziqeve dhe totalit të aktives).


⁷³ Rritja vjetore e treguesve të solventitetit rrjedh ekskluzivisht nga pozicionet kapitale të sistemit bankar të cilat kanë përshpejtuar rritjen, e cila në fund të vitit 2017 lëvizte në intervalet nga 6.1% e deri në 9.2%. Aktivitetet e sistemit bankar shënuan rritje më të ulët vjetore (3.9% - 5.7%), krahasuar me rritjen e pozicioneve kapitale.



Grafik 68

Masat për alokimin e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit në sistemin bankar

Në përqindje




Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga bankat.

Grafik 69

Norma e kapitalit themelor dhe norma e kapitalit të rregullt themelor për banka

Në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga bankat.

* Kapitali themelor dhe ai të rregullt themelor në vendin tonë është pothuajse i njëjtë dhe për këtë arsye norma e kapitalit themelor dhe norma e kapitalit të rregullt themelor në nivelin e sistemit bankar shumë pak ndryshojnë.

Analizuar veçmas për secilën bankë, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit tek pjesa më e madhe e bankave u rrit në krahasim me vitin e kaluar. Dallimi në mes të bankës me normë të mjaftueshmërisë së kapitalit më të lartë dhe asaj me më të ulët, u rrit në krahasim me 31.12.2016, por mjaftueshmëria e kapitalit më e ulët e regjistruar tek një bankë individuale u rrit dhe në fund të vitit 2017 arriti një nivel prej 13.4% (12.2% më 31.12.2016).

Normat e kapitalit të rregullt themelor dhe të kapitalit themelor në fund të vitit 2017 janë 14.2%. Sipas bankave individuale, norma e kapitalit themelor lëviz në intervalin nga 8.4 e deri në 27.4%, ndërsa norma e kapitalit të rregullt themelor lëviz në intervalin prej 6.8 e deri në 27.4%. Në fakt, këto dy norma ndryshojnë vetëm tek një bankë, e cila përveç kapitalit të rregullt themelor disponon edhe me kapital shtesë themelor.

Duke filluar nga gjysma e dytë të vitit 2017, bankat filluan të raportonin edhe për lartësinë e normës së borxhit⁷⁴, e cila është gjithashtu një nga kërkesat e reja të vendosura nga Basel 3. Norma mesatare e borxhit, e llogaritur për gjashtë muajt e fundit të vitit 2017, ishte 10.1% ndërsa për bankat në mënyrë individuale lëviz në intervalin nga 4.9% e deri në 17.4%.

Totali i aktives së ponderuara sipas rreziqeve u rrit për 5.7% ose 18,530 milionë denarë, e cila është si rezultat i rritjes së aktiveve të ponderuara sipas rrezikut kreditor (rritje prej 7.0% ose 19,811 milionë denarë), e cila kryesisht rrjedh nga aktiviteti kreditues i bankave në sektorin e "familjeve"⁷⁵.


⁷⁴ Në bazë të Vendimit mbi metodologjinë e menaxhimit të rrezikut të borxhit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 26/17), sipas së cilës bankat janë të detyruara të llogarisin normë të borxhit, si raport midis vlerës së kapitalit (kapitalit themelor) dhe vlera e ekspozimit të bankave (totali i aktives bilancore dhe jashtë bilancore siç përcaktohet në Vendim).

⁷⁵ Më shumë detaje rreth aktivitetit kreditor të bankave mund të gjenden në pjesën "Aktivitetet e bankave".



Grafik 70

Shuma dhe struktura e totalit të ekspozimit bilancor dhe jashtë bilancit, sipas peshave të rrezikut në milionë denarë në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga bankat.


Shënim: * Pesa mesatare e rrezikut llogaritet si raport midis aktives së ponderuar sipas rrezikut kreditor dhe ekspozimit të përgjithshëm bilancor dhe jashtë bilancit të sistemit bankar.

Në vitin 2017, niveli i rrezikshmërisë së aktiviteteve bankare, i matur si raport midis aktives së ponderuar sipas rrezikun kreditor dhe ekspozimin i përgjithshëm bilancor dhe jashtë bilancor, u rrit me 1.2 pikë përqindje. Në kuadër të aktives së ponderuara sipas rrezikut kreditor, rritje më të madhe kanë aktivitetet me peshë rreziku prej 100% dhe 150%, që kryesisht është për shkak të rritjes së kërkesave të kompanive të tjera tregtare dhe portofolit të kredive të vogla. Përkundër kësaj, aktivitetet e bankave, të cilat në llogaritjen e aktives së ponderuar sipas rrezikut kreditor përfshihen me një peshë rreziku prej 50%, janë ulur për 2,137 milionë denarë (ose për 11.1%), që rezulton nga ulja e kërkesave nga bankat.

Grafik 71

Indeksi Zet për sistemin bankar

Në nivele në nivele



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga bankat.

Sipas lëvizjes së indeksit zet (ang. Z-index)⁷⁶, stabiliteti i sistemit bankar shënon rënie, e cila është kryesisht për shkak të ndryshueshmërisë më të lartë të fitimeve të bankës. Por, edhe përkundër uljes së Indeksit Zet, stabiliteti i përgjithshëm i sistemit bankar është në nivel të lartë dhe nevojitet një goditje negative prej të paktën 35.5 devijimeve standarde nga norma e kthimit të aktives, në mënyrë vij deri në


⁷⁶Indeksi zet llogaritet në këtë mënyrë: $Z = \frac{AVATE/A}{\sigma(ROAA)}$, ku ROAA përfaqëson normën e kthimit të aktives mesatare, E janë kapitali dhe rezervat, A përfaqëson aktiven, ndërsa $\sigma(ROAA)$ paraqet devijimin standard nga norma e kthimit të aktive mesatare, e llogaritur për tre vitet e fundit. Nga formula mund të vërehet se kjo masë në vetvete kombinon disa tregues: treguesit e performancës, profitabilitetit të bankave (ROAA) tregues i nivelit të rrezikut në veprimtarinë bankare ($\sigma(ROAA)$) dhe masa për stabilitetin dhe solventitet të bankave (E/A). Kështu e llogaritur indeksi zet mat "distancën" e bankës nga shterrja e plotë e kapitalit të saj potencial, e shprehur në numër të devijimeve standarde nga norma e kthimit nga aktivitetet dhe, si i tillë, paraqet një masë e kapacitetit të bankave për të absorbuar humbjet. Indeksi zet zakonisht, shprehur në formë logaritmike (logaritmi natyror i formulës dhënë më parë), por më lehtë interpretohet dhe është më indikativ kur shprehur në nivele.



shterimin e plotë të potencialin kapital të sistemit bankar.

Grafik 72

Lartësia dhe struktura e koston (çmimit) të kapitalit* të bankave, aksionet e të cilave janë të listuara në tregun zyrtar të Bursës së Maqedonisë në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga bankat.

* Është llogaritur me aplikimin e të a.q. CAPM (Capital-AssetPricingModel-CAPM) ku çmimi i kapitalit përcaktohet si shumë e: 1) norma e kthimit pa rrezik (e përcaktuar si mesatare e kthimeve deri në maturim të obligacioneve qeveritare të listuara në bursën e Maqedonisë), 2) produkt i koeficientit beta për aksionin dhe diferenca midis normës së kthimit të tregut dhe normës së kthimit pa rrezik dhe 3) primi i rrezikut të vendit (të përcaktuar si diferenca midis kthimeve të eurobonove maqedonase dhe obligacioneve të krahasueshme gjermane).

Në përllogaritje janë përfshirë tetë banka, aksionet e të cilave janë të listuara në tregun zyrtar të bursës së Maqedonisë. Primi i rrezikut të tregut llogaritet si një mesatare e primeve të riskut të tregut për secilën bankë, të peshuar me madhësinë e aktives së tyre.


Kostoja e kapitalit (norma e kërkuar e kthimit e investitorëve në aksionet e bankave), e llogaritur duke aplikuar të ashtuquajturin modeli "CAPM", në mostër prej tetë bankave, shënoi një ulje vjetore, e cila është rezultat i zvogëlimit të primeve të rrezikut të vendit. Kostoja e kapitalit, e llogaritur me këtë model, u zvogëlua për 1.7 pikë përqindje dhe arriti një nivel prej 14.4% në fund të vitit 2017. Kjo është më e ulët me 1.5 pikë përqindje krahasuar me normën e kthimit në kapital, të realizuar nga bankat e përfshira në analizë. Norma më e ulët e kërkuar e kthimit nga aksionet e bankave rrjedh nga zvogëlimi i nivelit të primit të rrezikut të vendit, i cili u zvogëlua për 2.3 pikë përqindje si rezultat i zvogëlimit të kthimeve të eurobonove të lëshuara maqedonase dhe në një masë të vogël nga zvogëlimi i normës së kthimit pa rrezik (për 0.1 pikë përqindje). Tregtimi me aksionet e bankave në bursën e Maqedonisë shënoi rritje krahasuar me vitin 2016, e cila korrespondon me rritjen e çmimeve të këtyre aksioneve, duke përfshirë raportin midis çmimeve të aksioneve dhe vlerës së tyre kontabël.



Grafik 73

Raporti ndërmjet çmimit të tregut dhe vlerës kontabël (ang. price-to-book) të aksioneve për tre bankat më të mëdha të sistemit (majtas) dhe përqindja e numrit të përgjithshëm të aksioneve të emetuara të cilat janë tregtuar në periudhën e kaluar njëvjeçare (ang. turnover ratio) për tre bankat më të mëdha të sistemit (djathtas)

Në numër në herë në përqindje




Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga bankat.

Grafik 74

Struktura e ndryshimeve vjetore të mjeteve vetanake сопствените средства

Në milionë denarë në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga bankat.

Shënim: * Kjo i referohet ndryshimeve në shumën e instrumenteve tashmë të lëshuara të varura, të cilat rrjedhin nga përmbushja/mospërmbushja e rregullave rregullatore për përfshirjen e këtyre instrumenteve në llogaritjen e mjeteve vetanake.

5.2. Lëvizjet dhe cilësia e mjeteve vetanake të sistemit bankar

Në fund të vitit 2017, mjetet vetanake të sistemit bankar shënuan rritje vjetore prej 4,555 milionë denarë (ose 9.2%), që kryesisht ishte rezultat i fitimeve të mbajtura në fondet kapitale të bankave. Instrumentet vartëse janë të shkallës së dytë në rritjen vjetore të mjeteve vetanake. Për më tepër, 69.1% e shumës totale të detyrimeve në bazë të instrumenteve vartëse më 31.12.2017 kanë maturim të mbetur më të gjatë se 5 vjet (69.0% më 31.12.2016), e cila gjë iu mundëson bankave, në përputhje me rregulloret, përfshirjen e plotë të këtyre instrumenteve në llogaritjen e mjeteve vetanake. Megjithatë, duhet të kihet parasysh se instrumentet e varura janë një nga burimet më të shtrenjta të financimit për bankat, pasi ato përmbajnë një klauzolë vartëse⁷⁷. Përveç kësaj, gjatë vitit, një bankë konvertoi instrumentin hibrid të kapitalit në aksione të

⁷⁷ Sipas klauzolës për vartësi, në rast të falimentimit ose likuidimit të bankës, detyrimet e varura do të paguhen përpara se të shlyhen detyrimet ndaj aksionerëve të bankës dhe zotëruesve të instrumenteve hibride, por pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve të tjerë.



zakonshme, gjë që mundësoi përmirësimin e cilësisë së mjeteve vetanake. Sasia më e madhe e fitimit të riinvestuara në vitin 2017 rriti raportin midis fitimit të riinvestuara në mjetet vetanake dhe fitimin nga viti i kaluar. Kjo ishte e pritshme, duke pasur parasysh kërkesat e larta të kapitalit për bankat në vitin 2017.


Cilësia e mjeteve vetanake është në nivel të lartë, me pjesëmarrjen e kapitalit të rregullt themelor (komponenta më cilësore e mjeteve vetanake) në totalin e mjeteve vetanake prej 90.1%.

Grafik 75

Shuma dhe struktura e detyrimeve totale të bankave në bazë të instrumente të varura, sipas afatit të mbetur të maturimit (majtas) dhe normës së shpenzimeve të interesit *, për burimet individuale të financimit (djathtas)

Në milionë denarë

në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga bankat.

* Shënim: Norma e shpenzimeve të interesit llogaritet si raport midis shpenzimeve të interesit të realizuara gjatë vitit dhe shumës mesatare të burimeve të financimit, të llogaritura për datat e pesë tremujoreve të fundit.

** Detyrimet e përgjithshme të bankave të bazuara në instrumente të varura janë të shprehura në vlerën neto kontabël, nga bilanci i gjendjes.




5.3. Lëvizjet dhe struktura të kërkesave kapitale dhe kapitalin e lirë të sistemit bankar

Pjesa më e madhe e rritjes vjetore të mjeteve vetanake është përdorur për të përmbushur kërkesat minimale të kapitalit të përcaktuara në përputhje me vlerësimin dhe evaluimin mbikëqyrës (shtylla 2) dhe për plotësimin e shtresave mbrojtëse të kapitalit. Gjithashtu, rritje shënojnë kërkesat kapitale për mbulimin e rreziqeve. Pjesëmarrja e kapitalit "të lirë" mbi kërkesat minimale rregullatore dhe mbikëqyrëse është 8.8% (47.4% më 31.12.2016). Zvogëlimi i kapitalit të lirë është kryesisht për shkak të ndryshimeve rregullatore dhe kërkesave të më larta të kapitalit për shkak të detyrimit për të plotësuar shtresat mbrojtëse të kapitalit.

Grafik 76

Struktura e ndryshimeve vjetore (majtas) dhe gjendjes (djathtas) e mjeteve vetanake, sipas përdorimit për mbulimin e rreziqeve individuale në milionë denarë




Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga bankat.



Grafik 77

Shuma dhe struktura e kërkesave kapitale për mbulimin e rrezikut kreditor, sipas kategorive të ekspozimit në milionë denarë



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga bankat.

Kërkesat e përgjithshme të kapitalit për mbulimin e rreziqeve janë rritur (nga 1,482 milionë denarë ose 5.7%), si rezultat i rritjes së kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut kreditor (1,585 milionë denarë ose 7.0%). Në të kundërt, kërkesa i nevojshëm për mbulimin e rrezikut valutor është zvogëluar për 221 milionë denarë, ose me 29.9 për qind. Rritja e kërkesave për kapital për mbulimin e rrezikut kreditor vjen nga rritja e kërkesave tek portofolin e kredive të vogla.


Më shumë detaje mbi kërkesat e kapitalit për mbulimin e rrezikut dhe normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, në grupe individuale të bankave janë paraqitur në aneksin nr. 39

5.4. Stres-testi i qëndrueshmërisë së sistemit bankar ndaj goditjeve hipotetike

Testimi i kryer për qëndrueshmërisë së sistemit bankar dhe bankave individuale në Republikën e Maqedonisë ndaj goditjeve të simuluar kryesisht tregon qëndrueshmëri më të mirë të bankave në vitin 2017, krahasuar me vitin 2016. Mjaftueshmëria e kapitalit të sistemit bankar nuk bie nën 8%, me asnjë nga simulimet. Kjo është për shkak të mjaftueshmërisë më të lartë të kapitalit të sistemit bankar përpara kryerjes së simulimit, por edhe nga ndjeshmërisë më e ulët e theksuar tek disa banka ndaj goditjeve të supozuara.



Grafik 78
Krahasimi i rezultateve të simulimeve goditjeve kreditore dhe të kombinuara në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga bankat.

*Stres-testimi i përfshin simulimet në vijim:

Simulimi I: Rritja e ekspozimit jo-funksional kreditor ndaj subjekteve jo-financiare për 50%;

Simulimi II:

Rritja e ekspozimit jo-funksional kreditor ndaj subjekteve jo-financiare për 80%;

Simulimi III:

Transferimi i 10% të ekspozimit të rregullt kreditor tek ekspozimi jofunksional kreditor ndaj subjekteve jofinanciare;

Simulimi IV:

Riklasifikimi në "V-jofunksional" i pesë ekspozimeve më të mëdha të kredore ndaj subjekteve jofinanciare (përfshirë edhe subjektet e lidhura);

Simulimi V:

Rritja e ekspozimit jo-funksional ndaj subjekteve jo-financiare me 80% dhe rritja e normave të interesit nga 1 deri në 5 pikë përqind;

Simulimi VI:


Rritja e ekspozimit jo-funksional ndaj subjekteve jo-financiare për 80%, zhvlerësimi i kursit të këmbimit të denarit për 30% dhe rritja e normave të interesit nga 1 deri në 5 pikë përqind;

**Shënim: Ekspozimi kreditor ndaj subjekteve jofinanciare përfshin ekspozimin e përgjithshëm kreditor të zvogëluar për ekspozimin e bankave ndaj institucioneve financiare dhe shtetit, gjegjësisht ndaj klientëve nga veprimtaritë "aktivitete financiare dhe aktivitete të siguracionit" dhe "administrata publike dhe mbrojtje dhe siguri i detyrueshëm social".

Goditjet hipotetike në anën e rrezikut kreditor kanë ndikimin më të madh në stabilitetin e sistemit bankar. Në kuadër të ekspozimit kreditor ndaj subjekteve jofinanciare, simulimet tregojnë se rritja e nevojshme prej 179.7% të ekspozimit jo-funksional kreditor, gjegjësisht, kalim i 14.0% të ekspozimit të rregullt kreditor në ekspozimin jo-funksional kreditor, me qëllim që mjaftueshmëria e kapitalit të sistemit bankar të ulet në 8%. Këto simulime do të çonin në një rritje të trefishtë të pjesëmarrjes së ekspozimit jo-funksional kreditor të totalin e ekspozimit kreditor ndaj subjekteve jofinanciare.

Grafik 79

Niveli i nevojshëm i përkeqësimit të cilësisë së ekspozimit kreditor në mënyrë që mjaftueshmëria e kapitalit të sistemit bankar të ulet në 8% në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga bankat.



III. Ndryshimet më të rëndësishme bilancore dhe profitabiliteti i sistemit banker




1. Aktivitetet e bankave

Gjatë gjysmës së parë dhe gjysmës së dytë të vitit 2017, aktivitetet e bankave shënuan lëvizje të ndryshme. Në gjysmën e parë të vitit 2017 aktivitetet e bankave ishin nën ndikim të zvogëlimit të aktivitetit ekonomik dhe prezencës së vazhdueshme të risqeve nga ndodhitë politike vendore dhe nga mjedisi global. Totali i aktivitetit të bankave në këtë periudhë ka shënuar rritje modeste, e që ishte kryesisht rezultat e rënies së shënuar të potencialit depozitues të bankave në tremujorin e parë të vitit 2017 dhe rritjes minimale në tremujorin e dytë të vitit.

Grafik 80

Aktivi (majtas) dhe pasivi (djathtas) e sistemit bankar, rritja vjetore në milionë denarë (lartë) dhe struktura në % (poshtë)

Në milionë denarë



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të paraqitura nga ana e bankave.


Stabilizimi gradual i gjendjeve dhe të pritjeve të subjekteve ekonomike në gjysmën e dytë të vitit 2017 ka pasur ndikim përkatës në lëvizjet pozitive në tregun e këmbimit të valutave dhe në lëvizjen rritëse të bazës depozituese të bankave, para së gjithash të familjeve. Lëvizjet e tilla mundësuan rritje vjetore të potencialit depozitues të bankave, ndonëse i njëjti mbeti në nivel më të ulët në krahasim me rritjen e realizuar në vitin 2016. Rritja e depozitave në masë më të madhe ka rezultuar nga rritja e depozitave të familjeve në denarë, para së gjithash të depozitave në shikim, që sinjalizon një kthim gradual të preferencës



së klientëve për kursime në valutë vendore. Dinamika e aktivitetit kreditues të bankave, në masë të madhe i ka ndjekur lëvizjet e depozitave. Rritja kreditore rezultoi nga përkrahja e rritur kreditore të bankave në segmentin e familjeve, por edhe nga rritja e kreditimit të klientëve korporativ.

Grafik 81

Ndryshimi vjetorë i aktivitet të sistemit bankat
Në milionë denarë dhe në përqindje




Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Më 31.12.2017 totali i aktivitet të sistemit bankar ishte 461.992 milionë denarë dhe ka shënuar rritje vjetore prej 17.312 milionë denarë, përkatësisht për 3.9%. bëhet fjalë për një rritje më të ngadalësuar në krahasim me vitin 2016, dhe kjo mundet që kryesisht ti përshkruhet ngadalësimit të rritjes vjetore të bazës depozituese. Në pjesën më të madhe rritja e aktivitet rezulton nga rritja e aktivitetit kreditues me subjektet jo financiare dhe nga investimet e bankave në letra me vlerë.

Roli i përgjithshëm i sistemit bankar si ndërmjetësues financiar ka shënuar një rritje të caktuar në vitin 2017, rritje kjo më së shumti është prezentë te aktiviteti kreditues. Në krahasim me pjesën më të madhe të shteteve të analizuara të Unionit Evropian, ndërmjetësimi financiar në Republikën e Maqedonisë është në një nivel më të ulët, por qëndron në nivel të ngjashëm siç në disa të vendeve të regjionit.

Grafik 82

Shkalla e ndërmjetësimit financiar në Republikën e Maqedonisë dhe vendet e UE dhe regjionit
Në përqindje




Burimi: Banka Popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat, faqet zyrtare të FMN-së, BQE dhe bankave qendrore.

Shënim: Të dhënat kanë të bëjnë me muajin Dhjetor të vitit 2016, Me përjashtim të Maqedonisë (Dhjetor i vitit 2017) dhe Serbisë (Qershor i vitit 2016).

Grafik 83

Totali (lartë) dhe rritja vjetore (poshtë) e kredive të subjekteve jofinanciare
Në milionë denarë



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga ana e bankës.

Në pajtueshmëri me rregulativën, bankat ishin të obliguara që në periudhën 1.1-30.06.2016, të bëjnë çregjistrimin e kredive jofunkionale që kanë qenë tërësisht të rezervuara për më gjatë se dy vite, dhe të vazhdojnë me këtë praktikë për të gjithë kreditë që do të plotësojnë kushtet në fjalë. Kështu, në vitin 2016 u bë çregjistrimi i 12 miliardë denarë, përkatësisht gjysma e totalit të kredive jofunkionale. Çregjistrimet e ardhshme të realizuara në këtë bazë, janë në shumica të vogla, andaj efekti i tyre në dhjetor 2017 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak është jo i konsiderueshëm. Rreth 80% nga totali i kredive të çregjistruara i përkasin sektorit korporativ.

1.1 Kredi të subjekteve jo financiare


Në kushte të shëndetësimit të matur të ekonomisë vendore dhe stabilizimit të pritjeve dhe besimit të subjekteve ekonomike, kreditimi i personave jo financiar⁷⁸ në vitin 2017 ka shënuar rritje (për 16.613 milionë denarë, përkatësisht për 5.9%).

Analizuar sipas bankave të veçanta, ndryshimi vjetorë i kredive të subjekteve jofinanciare në masë më të madhe rezultojnë nga lëvizja e kredive të tetë bankave të sektorit bankar.

Grafik 84

Rritja vjetore e totalit të kredive të subjekteve jo financiare, sipas bankave individuale

Në milionë denarë dhe në përqindje




Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga bankat.

⁷⁸ Kreditë ndaj subjekteve financiare i përfshinë kreditë e personave jo financiar-rezidentë dhe joresidentë, edhe atë kreditë e shoqërive private dhe publike jo financiare, pushtetit qendrorë, vetëqeverisjes lokale, institucionet jofitimprurëse që ofrojnë shërbime për familje (kredi për klientë të tretë), personat që realizojnë aktivitete në mënyrë të pavarur dhe personat fizik (kredi për familjet).




Grafik 85
Struktura e kredive të familjeve, sipas produkteve
Në përqindje



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

Rritja kreditore në masë më të madhe ka rezultuar nga përkrahja e rritur kreditore e bankave për familjet, por edhe nga rritja e kreditimit të klientëve korporativ. Kjo në tërësi rezulton nga rritja e prirjeve të pjesës më të madhe të bankave për kreditim të familjeve për shkak të zvogëlimit të risqeve në krahasim me sektorin korporativ, përfshirë këtu edhe diversifikimin më të shprehur të "kreditimit të imët". Në fund të vitit 2017, te gjashtë nga gjithsej katërmbëdhjetë banka, participimi i kredive të familjeve në totalin e kredive të bankave është më e lartë në krahasim me participimin e kredive korporative. Konkretisht, kreditë e bankave në fjalë përbëjnë 48% të portfolios kredituese të sistemit bankar. Shikuar sipas produkteve kredituese, gati 72% nga totali i kredive të familjeve janë të dedikuara për financim të konsumit të pa dededuar të personave fizik⁷⁹.


Grafik 86
Struktura e totalit të kredive, sipas sektorit (majtas) valutës (në mes), dhe të kredive të rregullta sipas afatizimit të maturimit (djathtas)
në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

⁷⁹ Kredite konsumatore, tejkalime të lejuara në llogari dhe kartela kreditore.

Grafik 87

 Ndryshime vjetore te kreditë, sipas sektorit, valutës dhe afatizimit të maturimit
 Në milionë denarë dhe në përqindje


Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga bankat..


Në vitin 2017 rritja e kredive në denarë e përcaktoi rritjen vjetore të totalit të aktivitetit kreditues të bankave, në kushte të zvogëlimit të mëtejshëm të kredive në valutë të huaj. Kreditë korporative⁸⁰ kanë një kontribut diç më të lartë (54.8%) në rritjen e kredive në denarë, në krahasim me kontributin (45%) e kredive ta familjeve. Njëkohësisht edhe zvogëlimi i kredive në valutë të huaj gati në tërësi rezulton nga rënia e kredive të shoqërive jo financiare⁸¹. Kreditë në denarë me klauzolë valutore kanë shënuar rritje vjetore prej 1791 milionë denarë (ose 2.4%), ndërsa bartës kryesorë të kësaj rritje janë kreditë për familjet.

⁸⁰ Kreditë e familjeve në denarë në bazë vjetore janë zmadhura për 7.313 milionë denarë (ose për 10.8%), ndërsa rritja vjetore e kredive në denarë të shoqërive jo financiare është 8.891 milionë denarë (ose 10.3%).

⁸¹ Kreditë devizore të shoqërive jo financiare në bazë vjetore zvogëlohen për 2.782 milionë denarë (ose 6.5%).




Grafik 88
Depozitat e subjekteve jofinanciare
Në milionë denarë




Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Grafik 89
Ndryshimi vjetorë i depozitave të subjekteve jo financiare në milionë denarë dhe në përqindje



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

Grafik 90
Kontributi i komponentëve të veçantë në rritjen vjetore të totalit të depozitave të subjekteve jofinanciare në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Shikuar sipas afatizimit të maturimit, kreditimi afatgjatë edhe më tutje mbetet forca kryesore lëvizëse e rritjes së aktivitetit kreditues. Kreditë afatgjata kanë shënuar rritje prej 7%, më çka në mënyrë shtesë është përforcuar participimin në totalin e kredive. Konkretisht, 78.3% nga rritja e kredive afatgjata rezulton nga kreditimi në denarë⁸².

1.2. Depozite të subjekteve jo financiare

Norma negative e rritjes së depozitave të bankave në tremujorin e parë të vitit 2017 dhe rritja minimale e tyre në tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit, kontribuuan për një ngadalësim të matur të shkallës së rritjes së totalit të potencialit depozitues të bankave në vitin 2017, edhe pranë rritjes solide të depozitave të realizuar në tremujorin e fundit të vitit.


Potenciali depozitues i bankave ka mbetur burim kryesor i financimit të aktiviteteve bankare (73.4% nga totali i mjeteve, që paraqet një participim gati të pandryshuar në krahasim me fundin e vitit 2016). Dinamika vjetore e bazës depozituese

⁸² Kreditë afatgjata në denarë shënojnë rritje vjetore prej 11.279 milionë denarë, që në masë më të madhe rezultoi nga rritja e kredive afatgjata në denarë të familjeve (për 6.896 milionë denarë), dhe në pjesë më të vogël nga rritja e kredive afatgjata në denarë të shoqërive jo financiare (për 4.340 milionë denarë).



Grafik 91

Rritja vjetore e depozitave të subjekteve jofinanciare, sipas bankave përkatëse
Në milionë denarë dhe në përqindje




Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

të bankave na masë më të madhe (82.9%) u përcaktua nga **depozitat e familjeve**, rritja e të cilave (për 13.662 milionë denarë ose 6.2%⁸³) ishte gjashtëfish më e lartë se rritja vjetore e **depozitave të shoqërive jo financiare** (2.158 milionë denarë, ose 2.4%⁸⁴). Në rastin konkret familjet edhe më tutje mbeten deponenti më i rëndësishëm në sistemin bankar vendor, me pjesëmarrje prej 69.8% në totalin e depozitave (68.5% më 31.12.2016). Shikuar sipas bankave të veçanta, ndryshimi vjetorë i totalit të bazës depozituese në masë më të madhe rezulton nga lëvizjet te depozitat e pesë bankave më të mëdha të sektorit bankar.

Grafik 92

Ndryshimi vjetor i depozitave, sipas sektorit, valutës dhe afatizimit të maturimit në milionë denarë dhe në përqind



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Edhe në vitin 2017 është vërejtur denarizim i depozitave të bankave, edhe pse pjesëmarrja e depozitave në denarë në totalin e depozitave (e që është 56.9%⁸⁵ në fund të vitit 2017) ka mbetur e pandryshuar në krahasim me 31.12.2016. Në vitin 2017, depozitat në denarë kanë shënuar rritje prej 9.597 milionë denarë, ose për 5.2% (4.1% në vitin 2016), rritje kjo që në masë më të madhe ishte e kushtëzuar nga rritja e depozitave të familjeve (për 8.329 milionë denarë ose për 7.4%⁸⁶). Kundrejt kësaj, rritja vjetore e depozitave në deviza (5.917 milionë denarë ose 4.3%⁸⁷) ka shënuar ngadalësim, ndërsa familjet kanë pasur kontributin më të lartë në rritjen e tyre (90.1%).

⁸³ 12,7% në vitin 2016.

⁸⁴ 2,6% në vitin 2016.

⁸⁵ 62.5% nga totali i depozitave në denarë u përkasin depozitave të familjeve (61.3% më 31.12.2016) .


⁸⁶ 11.2% në vitin 2016.

⁸⁷ 7.6% në vitin 2016.



Grafik 93


Struktura e totalit të depozitave, sipas sektorit, valutës dhe afatizimit të maturimit në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga bankat

Grafik 94

Struktura maturuese e depozitave të familjeve në përqind



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga bankat.

Në vitin 2017 është shënuar shkurtrim i mëtejshëm i afatit të maturimit të bazës depozituese të subjekteve jo financiare. Për të gjashtin vit në radhë, depozitat afatshkurtra shënojnë normë negative të rritjes, në llogari të depozitave në të parë. Në rritjen e këtyre depozitave⁸⁸, familjet kanë një kontribut dukshëm më të lartë (81.6%) në krahasim me kontributin e sektorit korporativ (11.6%). Rritja vjetore e depozitave afatgjata, është 6.372 milionë denarë (ose 7.5%), dhe në masë më të madhe rezultojnë nga rritja e depozitave në denarë të familjeve (me një kontribut prej 51.3%). Transformimi i vërejtur në afatet e maturimit të depozitave, edhe pse rezultojnë me zvogëlimin e të dalave në emër të normave të interesit në bilancet e bankave, megjithatë sjellin deri në komplikim të menaxhimit me riskun e likuiditetit dhe imponon nevojën për një kujdesëshmëri më të lartë dhe sipas të gjitha gjasave edhe nevojën për të ruajtur shumën më të lartë të rezervave likuide.


⁸⁸ Rritja vjetore e kredive në dukje të familjeve në masë më të madhe (57.5% rezultoi nga kreditë në denarë dhe në masë më të vogël (42.5%) nga depozitat devizore. Rritja vjetore e depozitave në shukim të shoqërive jo financiare në tërësi kishte të bëjë me depozitat në denarë.



1.3 Aktivitete tjera

Grafik 95


Struktura maturuese e investimeve në bankave në letra shtetërore me vlerë në përqind



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave e paraqitura nga ana e bankave.

Grafik 96

Struktura (lartë) dhe ndryshimi vjetorë (poshtë) i portfolios së letrave me vlerë dhe investimet në shoqëri të asociuara në përqind



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave e paraqitura nga ana e bankave.

Në fund të vitit 2017, **investimet e bankave në letra me vlerë** dhe shoqëri të asociuara⁸⁹ (sipas vlerës kontabël neto) shënuan rritje prej 3.036 milionë denarë ose për 5.3%. Lëvizja e tillë është kryesisht pasojë e rritjes së plasmanëve të bankave në obligacione vendore shtetërore. Me këtë, participimi i portfolios së letrave me vlerë dhe investimeve në shoqëri të asociuara në totalin e aktivitet të bankave arriri në **13% (nga 12.8% në fund të vitit 2016)**. Rritja e investimeve të bankave në obligacione vendore shtetërore (e që është më e shprehur në rastin e obligacioneve shtetërore dyvjeçare) në vlerë prej 3324 milionë denarë (ose 39.6%) kishte kontribut më të lartë në zmadhimin e totalit të portfolios së letrave me vlerë. Rritja në bazë vjetore, nga 2003 milionë denarë (ose 8.7%) kanë shënuar edhe investimet e bankave në bonot e thesarit⁹⁰. Kundrejt kësaj, investimet në bono shtetërore kanë shënuar rënie në bazë vjetore (për 2782 milionë denarë, ose për 11.5%). **Në rrethana të alternativave të kufizuara investuese**, specifika bazë e portfolios së letrave me vlerë të bankave edhe më tutje mbetet mosdiversifikimi dhe mbizotërimi i bonove shtetërore dhe të letrave me vlerë të borxhit të emituara nga Republika e Maqedonisë.


⁸⁹ Fonde pensionale dhe filiale – shoqëri tjera financiare.

⁹⁰ Në Janar të vitit 2017, Banka Popullore solli vendim për normën e interesit të bonove të thesarit për 0.25 pikë përqindje, ndryshim ky që u ndoq nga një zmadhim i shumën së ofruar të bonove të thesarit prej 23.000 milionë denarë në 25.000 milionë denarë, ndërsa në mars të vitit 2017 me rritje për 30.000 milionë denarë, respektivisht për 5.000 milionë denarë më shumë në krahasim me nivelin e bonove të maturuara të thesarit. Në Korrik të vitit 2017, Banka Popullore bëri zvogëlim të shumës së ofruar të bonove të thesarit (prej 30.000 milionë denarë në 27.500 milionë denarë) dhe në Gusht të vitit 2017 (nga 27.500 milionë denarë në 25.000 milionë denarë). Në Mars të vitit 2018, Banka Popullore bëri lehtësim shtesë të politikës monetare, përkatësisht bëri zvogëlim në normës së interesit të bonove të thesarit nga 3.25% në 3.00%, me atë që shuma e ofruar mbeti e pandryshuar (25.000 milionë denarë).



Grafik 97

Ndryshime vjetorë i plasmanëve të institucionet financiare (majtas), obligimet në bazë të kredive (në mes) dhe të depozitave të shoqërive financiare (djathtas) në përqind



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave e paraqitura nga ana e bankave.

Në vitin 2017 plasmanët në banka dhe institucione tjera financiare shënuan rënie (për 1299 milionë denarë, ose 2.6%), gati tërësisht si rezultat i zvogëlimit të kredive afatgjata ndaj bankave vendore në valutë të huaj, të plasura nga "BMPZH" Sh.A. Shkup. Nga ana tjetër u shënuar rritjes e saldove të llogarive dhe depozitave në banka të huaja, rritje kjo që rrjedhon nga depozitat afatshkurta në banka të huaja⁹¹.

Në pjesën e pasivës, **obligimet në bazë të kredive** u zvogëluan për 5.597 milionë denarë ose për 15.5%, që në masë më të madhe rezultoi nga zvogëlimi i obligimeve në bazë të kredive afatgjata ndaj shoqërive financiare jo rezidente, respektivisht pagesa e borxheve nga ana "BMPZH" Sh.A. Shkup ndaj institucioneve financiare ndërkombëtare. Kjo ishte shkak edhe për zvogëlim të obligimeve në bazë të huazimit afatgjatë ndër bankar në valutë të huaj (pagesa e borxhit të një pjesë të bankave vendore ndaj "BMPZH" Sh.A. Shkup).

Në vitin 2017, depozitat nga bankat dhe institucionet tjera financiare edhe më tutje janë burim shumë i vogël i financimit të bankave, pjesëmarrja e të cilëve në totalin e pasivit dhe në totalin e obligimeve është 4.8% dhe 5.5% përkatësisht. Në krahasim me vitin 2016, këto depozite kanë shënuar rritje (për 2271 milionë denarë ose 11.5%), rritje jo që në masë më të madhe u kushtëzua nga depozitat afatgjata të shoqërive financiare rezidente (nga një deri në dy vite në denarë). Një kontribut diç më të vogël në rritjen e depozitave nga bankat dhe institucionet tjera financiare kishin edhe depozitat e rritura të shoqërive financiare jo rezidente.⁹²

Edhe në vitin 2017, bankat kanë vazhduar që aktivitete e tyre të kryejnë kryesisht në tregun vendor. Në fakt, kërkesat dhe obligimet nga/ndaj jo rezidentëve janë në nivel të ulët, ndërsa në vitin 2017 është shënuar edhe zvogëlim shtesë i obligimeve ndaj jo rezidentëve (për 1858 milionë denarë, ose 5%), si rezultat i zvogëlimit të theksuar të obligimeve në bazë të kredive afatgjata ndaj shoqërive financiare jo rezidente. Kundrejt kësaj, kërkesat nga jo rezidentët kanë shënuar rritje të vogël prej 323 milionë denarë (ose për 0.9%). Në vitin 2017, sistemi bankar ka kërkesa më të larta në krahasim me obligimet

⁹¹ Saldot e llogarive dhe depozitave pranë bankave të huaja shënuar rritje për 403 milionë denarë ose për 1.2%. Në suaza të tyre, depozitat afatshkurta jashtë vendit në valutë të huaj shënuar rritje prej 3041 milionë denarë ose 18% (më së shumti depozitat e afatizuara nga një deri në tre muaj), ndërsa saldot e llogarive të rregullta rrjedhëse jashtë vendit në valutë të huaj u zvogëluan për 2539 milionë denarë, ose për 14.8%.


⁹² Depozitat e shoqërive financiare joresidente shënuar rritje prej 638 milionë denarë ose 13.6%. Në suaza të tyre, depozitete afatshkurta në valutë të huaj shënuar rritje prej 2.338 milionë denarë, kundrejt zvogëlimit të saldove të llogarive rrjedhëse të bankave të huaja në denarë për 1.593 milionë denarë.



ndaj jo rezidentëve. Pjesëmarrja e kërkesave dhe obligimeve të bankave nga/drejt jo rezidentëve në totalin e mjeteve/obligimeve janë 7.8% dhe 7.6%, përkatësisht⁹³.

Grafik 98

Obligime (majtas) ndaj dhe kërkesa (djathtas) nga jo rezidentët në milionë denarë dhe në përqindje



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave e paraqitura nga ana e bankave.

Bankat vendore, në vazhdimësi kanë qenë neto-huazues ndaj subjekteve amë⁹⁴. Megjithatë, shfrytëzimi i borxheve ndaj subjekteve amë⁹⁵ nuk paraqet burim të rëndësishëm të financimit të aktivitetit të tyre. Kështu pjesëmarrja e obligimeve ndaj personave amë (përfshirë edhe obligimet e subordinuara dhe instrumentet kapitale hibride) në totalin e aktivitetit të sistemit bankar vendor, si dhe në obligimet ndaj jo rezidentëve⁹⁶, në fund të vitit 2017 është 2.0% dhe 25.9%, përkatësisht Totali i obligimeve të bankave ndaj subjekteve amë të tyre në krahasim me vitin 2016 është zvogëluar për 267 milionë denarë, ose për 2.9%. **Kërkesat nga personat amë të bankave janë shumë të vogla dhe në vitin 2017 përfshijnë vetë, 4.0% nga totali i mjeteve të sektorit vendor bankar, ndërsa participimi i tyre në totalin e kërkesave ndaj jo rezidentëve është 5%. Në krahasim me vitin 2016, kërkesat nga subjektet amë të bankave shënuan rritje prej 205 milionë denarë, ose për 12.7%.**

⁹³ Shikuar sipas bankave të veçanta, pjesëmarrja e kërkesave të bankave nga jo rezidentët në totalin e aktivitetit lëviz në interval nga 1.3% në 18.9%, ndërsa participimi i obligimeve të bankave ndaj jo rezidentëve në totalin e pasivitetit lëviz në intervalin nga 0.1% deri në 15%. "BPPZH" Sh.A. Shkup nuk është e përfshirë në analizën në fjalë.

⁹⁴ Më 31.12.2017 tetë nga gjithsej njëmbëdhjetë banka janë neto-huazues ndaj subjekteve amë.


⁹⁵ Burimet e financimit të bankave nga subjektet amë janë kryesisht në formë të depozitave afatshkurta dhe obligimeve në bazë të instrumenteve kapitale të subordinuara dhe hibride.

⁹⁶ Shikuar sipas bankave të veçanta, participimi i obligimeve të bankave ndaj personave amë në totalin e obligimeve ndaj jorezidentëve lëviz në intervalin nga 0.001% deri në 85.6%. Shikuar sipas bankave të veçanta, participimi i obligimeve të bankave ndaj personave amë në totalin e pasivitetit lëviz në interval nga 0.001% deri në 12.9%.



Grafik 99

Obligime (lartë) dhe kërkesa (poshtë) ndaj/prej personave amë të bankave në milionë denarë dhe në përqind



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave e paraqitura nga ana e bankave.




2. Profitabiliteti

Edhe në vitin 2017 sektori bankar ka shënuar rritje të fitimit, por me një shkallë dukshëm më të ulët të rritjes në krahasim me disa vitet paraprake. Kontribut më të madhe në zmadhimin e fitimit në vitin 2017 kanë pasur të ardhurat që nuk janë realizuar në bazë të normës së interesit, që është në kundërshtim me trendin e zakonit për disa vitet e fundit, periudhë kjo në të cilën në vazhdimësi neto të ardhurat në bazë të normës së interesit kanë kontribuar më së shumti në rritjen e fitimeve. Në fakt, rritja e të ardhurave neto në bazë të normave të interesit ka shënuar një ngadalësim të konsiderueshëm, që në masë më të madhe rezulton nga rënia më e shprehur e të ardhurave nga shoqëritë jo financiare në vitin 2017, në krahasim me rëniën e shënuar në vitin 2016, në ushte të zvogëlimit paralel më të ngadaltë i të dalave në bazë të normës së interesit nga puna e familjeve, në krahasim me ngadalësimin me ngadalësimin e shënuar në vitin paraprak. Kostot për korrigjim të vlerës shënuan rritje më të konsiderueshme në vitin 2017, kundrejt zvogëlimit të shënuar në vitin 2016 dhe gjithashtu kontribuuan në ngadalësimin e rritjes vjetore të fitimit të sistemit bankar. Kostot operative edhe më tutje vazhdojnë të rriten, por në mënyrë të ngadalësuar në krahasim me vitin 2016. Lëvizjet e tilla kanë shkaktuar një zvogëlim të caktuar, kryesisht minimal, të pjesës më të madhe të treguesve të profitabiliteti dhe efikasitetit të sistemit bankar, të cilat edhe pranë kësaj vazhdojnë të qëndrojnë në nivele relativisht të larta. Normat aktive dhe pasive të interesit kanë vazhduar të zvogëlohen edhe në vitin 2017. Në kushte të normave më të ulta të interesit, një nga sfidat më të mëdha me të cilat ballafaqohen bankat është ruajtja e profitabilitetit të lartë dhe siguri i vazhdueshëm i shumave solide të ardhurave neto në bazë të normës së interesit.

Grafik 100

Fitimi neto pas tatimit (lartë) dhe ndryshimi vjetorë i të ardhurave dhe të dalurave kyç (poshtë) në milionë denarë



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave e paraqitura nga ana e bankave.

2.1 Tregues të profitabilitetit dhe efikasitetit të sistemit bankar


Në vitin 2017, sistemi bankar të shënuar fitim prej 6.6 miliardë denarë, që paraqet rritje prej 230 milionë denarë ose 3.6% në krahasim me fitimin e realizuar në vitin 2016. Rritja vjetore e fitimit të shënuar, është më e ulët në krahasim me periudhën paraprake pesëvjeçare (2011-2016), kur është rritur mesatarisht për 40% në bazë vjetore. Në vitin 2017, kontribut më të lartë në zmadhimin e fitimit kanë pasur të hyrat jashtë-interesit, e shumë pas tyre ngecin të ardhurat neto nga normat e interesit, lëvizje kjo që është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me trendin e zakonshëm – të ardhurat neto në bazë të normës së interesit të kontribuojnë më shumë në rritjen e fitimit. Ngadalësimi më i shprehur i rritjes së të ardhurave neto në bazë të normës së interesit (ritja e tyre në vitin 2017 është



gati katërfish më e vogël se rritja e shënuar në vitin 2016) dhe rritja e kostove për korrigjim të vlerës në vitin 2017 (kundrejt zvogëlimit të tyre në vitin 2016) kanë dhënë kontributin më të lartë në ngadalësimin e konsiderueshëm të rritjes së fitimit në vitin 2017. Vetëm dy banka e kanë përmbyllur vitin me humbje.

Grafik 101

Norma e kthimit të aktivitetit mesatar (POAA) dhe të kapitalit dhe rezervave mesatare (POAE) (majtas) dhe dinamika e komponentëve të tyre (djathtas) në përqindje



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave e paraqitura nga ana e bankave.

Rënia e konsiderueshme e rritjes së fitimit në vitin 2017 ka ndikuar në treguesit e profitabiliteti dhe të efikasitetit të sektorit bankar. Pas trendit disavjeçarë të rritjes permanente, shkallët e kthimit të aktivitetit mesatar dhe të kapitalit mesatar dhe rezervave⁹⁷ shënojnë rënie minimale për nga 0.1 pikë përqindje dhe në fund të vitit 2017 arrijnë 13.5% dhe 1.4%, përkatësisht. Analiza e komponentëve të veçantë⁹⁸, të shkallëve të kthimit sinjalizon një zvogëlim të matur të margjinës së fitimit dhe qarkullimit të aktivitetit mesatar të ponderuar me risqet, që në mënyrë

⁹⁷ Aktiviteti mesatar dhe kapitali dhe rezervat janë të paraqitura si mesatare të gjendjes së aktivitetit, respektivisht kapitalit dhe rezervave më 31.12.2016 dhe 31.12.2017 година.


⁹⁸ Norma e kthimit të kapitalit mesatar dhe rezervave mundet të paraqitet mesa vijon: $POAE = PCR * SS * AA * RWARWA = PS * SRWA * ACR * RWAA = PM * RWAturnover * L * RBAratio$, ku: P=fitimi pas tatimit; CR=kapitali dhe rezervat mesatare; S=totali i të ardhurave të rregullta; A=aktiviteti mesatar; RĒA=aktiviteti i ponderuar për riskun; PM=margjina e fitimit; RĒAturnover=qarkullimi i aktivitetit të ponderuar për riskun; L=leverixhi ose borxhi; RBAratio=treguesi i nivelit të pranuar të riskut.

Margjina e fitimit paraqet raport në mes fitimit (humbjes) dhe totalit të ardhurave të rregullta.



Grafik 102


Neto margjina e normës së interesit më 31.12.2017, në nivel të sektorit bankar (lartë) dhe sipas bankave të veçanta (poshtë) në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

Grafik 103

Tregues të efikasitetit operacional të bankave në përqind



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave e paraqitura nga ana e bankave.

adekuate ka kontribuar edhe në zvogëlimin minimal të shkallëve të kthimit. Treguesit e profitabilitetit dhe efikasitetit të sistemit bankar dhe grupeve të veçanta të bankave janë të paraqitura në aneksin nr. 40

Neto margjina e normës së interesit është zvogëluar për 0.1 pikë përqindje dhe është 4.0% për vitin 2017, që rezulton nga rritja më e shpejtë e aktivitetit mesatar interes-prurës (për 14.739 milionë denarë ose për 3.9%), në krahasim me zmadhimin e të ardhurave neto nga interesi (për 243 milionë denarë ose për 1.6%).

Në fakt, në kushte të ngadalësimit të rritjes së të dy komponentëve të neto margjinës së interesit, përsëri më i konsiderueshëm ishte ngadalësimi i rritjes së të ardhura neto nga interesi (zmadhimi i të ardhura neto nga interesi ka shënuar ngadalësim prej 7.2% në vitin 2016 në 1.6% në vitin 2017⁹⁹, përdërisa rritja e aktivitetit mesatar interes-prurës ka shënuar ngadalësim prej 7.3% në vitin 2016 në 3.9% në vitin 2017).

Zmadhimi i të ardhurave neto në bazë të normës së interesit në vitin 2017, rezulton nga rënie më e shprehur e të dalurave në bazë të normës së interesit (për 471 milionë denarë, ose për 9.9%) në krahasim me zvogëlimin e të ardhurave në bazë të normës së interesit (për 229 milionë denarë ose për 1.1%). Kontribut më të lartë (prej mbi 90%) në zvogëlimin e të dalurave në emër të normës së interesit kanë dhënë familjet, te të cilat kjo kategori e të dalurave është zvogëluar për 15.8% (ose për 427 milionë denarë). Përkundër kësaj, rënia e të hyrave në emër të normës së interesit ishte kryesisht prezentë te sektori i

⁹⁹ Ngadalësimi drastik i rritjes së të ardhurave neto në emër të normës së interesit rezulton nga shkurtimi më i shprehur i të ardhura në emër të normës së interesit nga puna me shoqëritë jofinanciare në vitin 2017, në krahasim me shkallën e zvogëlimin të këtyre të hyra në vitin 2016 (në krahasim me vitin 2015), që kontribuoi në një rënie më të vogël të dalurave në emër të normës së interesit, respektivisht ngadalësim të rritjes së të hyrave neto në emër të normës së interesit.




shoqërive jo financiare (ku të ardhurat në emër të normës së interesit kanë shënuar rënie për 637 milionë denarë ose 5.6%). Përfundimisht, tre të katërtat e aktivitetit interes-prurës rrjedhon nga rritja e aktivitetit kreditues me sektorin "familje".

Grafik 104

Shuma (lartë) dhe normat vjetore të ndryshimit (poshtë) të kostove për korrigjim të vlerës së mjeteve financiare dhe jofinanciare

në milionë denarë (lartë) dhe në përqind (poshtë)



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave e paraqitura nga ana e bankave.

Treguesit e efikasitetit operativ të sistemit bankar nuk kanë lëvizur në kahe të njëjta. Kështu, kostot operative për njësi të totalit të hyrave shënojnë rënie, për njësi të ardhurash nga normat e interesit shënon rritje, ndërsa për njësi të mesatares së aktivitetit qëndrojnë në nivel të pandryshueshëm. Kostot operative në vitin 2017 janë më të larta për 290 milionë denarë, ose për 2.5%¹⁰⁰ në krahasim me vitin 2016. Kontribut më të madh në zmadhimin e kostove në fjalë ka dhënë rezerva e posaçme për humbje kreditore nga ekspozime jashtë bilancore¹⁰¹, kategori kjo që në vitin 2017 është për 217 milionë denarë më e lartë, në krahasim me vitin paraprak. Gjithashtu, rritje vjetore prej 108 milionë denarë (ose për 2.3%) kanë shënuar edhe kostot për të punësuarit, të cilët kanë participim më të lartë individual në kostot operative (40.4%). Nga ana tjetër, totali i të hyrave nga funksionimi i rregullt i bankave shënuar rritje më të shprehur (për 4.7% ose për 1068 milionë denarë), në çka kontribut më të madh prej 77.3% kishin të ardhurat jo nga interesi (para së gjithash në bazë të fitimeve kapitale nga shitja e mjeteve dhe nga arkëtimi i kërkesave paraprakisht të çregjistruara). Edhe pranë ngadalësimit më të shprehur, tani më të theksuar, të rritjes së të hyrave neto në bazë të normës së interesit (rritje prej 1.6% në vitin 2017), ato edhe më tutje kanë participimin më të lartë në totalin e të hyrave nga puna e rregullt (65.4% për vitin 2017).


¹⁰⁰ Për krahasim, kostot operative në vitin 2016 ishim për 340 milionë denarë (ose për 3.1%) më të larta në krahasim me vitin 2015.

¹⁰¹ Duke filluar nga 1.1.2018, në përputhshmëri me SNRF 9 instrumentet financiare, rezerva e veçantë për humbje potenciale kreditore nga ekspozimi jashtëbilancorë (përfshirë edhe lehtësimet për këtë rezervë) do të evidentohet si pjesë e kostove për korrigjim të vlerës, e jo si pjesë e kostove operative të bankave.



Grafik 105

Tregues të raportit në mes kostove për korigjim të vlerës dhe fitimit dhe të ardhurave neto në bazë të normave të interesit në milionë denarë i në përqind




Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave e paraqitura nga ana e bankave.

Në vitin 2017, totali i kostove për korigjim të vlerës shënon rritje për 11.1% (ose për 495 milionë denarë) në krahasim me vitin 2016. Kostot e rritura (neto) për korigjim të vlerës burojnë nga kostot më të larta të bëra për korigjim të vlerës së mjeteve financiare (rritje prej 1232 milionë denarë ose për 32.7%), që nga ana tjetër është pasojë e keqësimit të kapacitetit kredimarrës të klientëve nga veprimtaritë si prodhimtaria e metaleve, makinave, mjeteve dhe pajisjeve, informacione dhe komunikime, industria ushqimore dhe pjesa tjetër e industrisë së përpunimeve. Kundrejt kësaj, kostot (neto) për korigjim të vlerës së mjeteve jo financiare shënojnë zvogëlim prej 737 milionë denarë (ose për 107.2%), që rezulton nga shitjet e mallit të konfiskuar në emër të kërkesave të pa arkëtuara.

Grafik 106

Norma aktive (lartë) dhe pasive (poshtë) të interesit Në përqind



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

2.2 Lëvizja e normave të interesit dhe diapazonit të normave të interesit

Zvogëlimi i normave aktive dhe pasive të interesit të bankave, të të gjitha valutave, vazhdoi edhe në vitin 2017¹⁰².


Norma mesatare aktive dhe pasive e interesit në vitin 2017 janë 6.0% dhe 1.6%, përkatësisht që paraqet zvogëlim për 0.4 dhe 0.2 pikë përqindje përkatësisht, në krahasim me vitin paraprak. Rënia më e lartë e normës mesatare të interesit prej 0.5 pikë përqindje është shënuar te kreditë në deviza¹⁰³. Analiza krahasimore e normave të interesit në Dhjetor të vitit 2017 në krahasim me muajin e njëjtë të vitit 2016 sinjalizon zvogëlim të të gjitha normat aktive dhe pasive të interesit.

¹⁰² Gjatë vitit 2017, norma bazë e interesit, norma e interesit të bonove të thesarit, u zvogëluar në shkurt të vitit 2017 (nga 3.5% në 3.25%).

¹⁰³ Rënie për 0.5 pikë përqindje është shënuar edhe te norma e interesit të depozitave në denarë me klauzolë valutore, por totali i depozitave në fjalë është minimal.



Grafik 107
Diapazoni i normës së interesit, sipas
valutës
Në pikë përqindje



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

Gjatë vitit 2017, edhe diapazonet e normave të interesit kanë shënuar rënie. Më 31.Dhjetor.2017, diapazoni në mes normave aktive dhe pasive të interesit ishte 4.2 pikë përqindje, pra është zvogëluar për 0.2 pikë përqindje në krahasim me 31.Dhjetor.2016. Diapazoni mesatarë në mes normave aktive dhe pasive të interesit në vitin 2017 është 4.4. pikë përqindje që paraqet zvogëlim prej 0.2 pikë përqindje në krahasim me vitin 2016.




Analizë e profitabilitetit të bankave në kushte të normave të ulta dhe rrenëse të interesit

Bankat në Republikën e Maqedonisë kryesisht implementojnë formë tradicionale të veprimit-bëjnë grumbullimin e depozitave nga sektori privat vendor dhe plasim i kredive te sektori jo financiar vendor. Andaj, është e pritshme që të ardhurat neto nga normat e interesit të jenë komponenti më i rëndësishëm i të hyrave të bankave dhe për pasojë edhe burim kryesorë i realizimit të fitimeve. Duke filluar nga vit 2012, fitimi i sistemit bankar në Republikën e Maqedonisë ka shënuar një trend të rritjes permanente, me atë që shkallët e rritjes lëvizin rreth 40%, mesatarisht. Përfundimisht për vitin 2016 kur është shënuar një rritje modeste e fitimit për 3.6%.

Grafik 108


Struktura (majtas) dhe shfrytëzimi (djathtas) i të ardhurave të përgjithshme në përqindje



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave e paraqitura nga ana e bankave.

Grafik 109

Të ardhura në bazë të interesit dhe të dalurave në bazë të normës së interesit, gjendje dhe rritje në milionë denarë dhe në përqindje



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të paraqitura nga ana e bankave.


Në periudhë 2007-2014, të ardhurat neto në emër të normës së interesit kanë shënuar një rritje gati permanente të pjesëmarrjes edhe ashtu mjaft të shprehur në strukturën e totalit të hyrave. Në vitin 2015 dhe 2016, pjesëmarrja e të hyrave neto në emër të normës së interesit ka mbetur gati e pandryshuar, ndërsa në vitin 2017 ky participim është zvogëluar për 2 pikë përqindje. Në po të njëjtën periudhë kohore, të ardhurat neto nga provizionet kanë zvogëluar pjesëmarrjen në totalin e të hyrave, ndërsa një ndryshueshmëri pakëz më e shprehur vërehet te pjesëmarrjet e të ardhurave tjera të rregullta, participimi i të cilave gjatë tre viteve të fundit kë shënuar rritje. Analiza e këtillë, vetëm e rikonfirmon shfrytëzimin e modelit tradicional afarist në punë e bankave dhe madje sinjalizon edhe përforsim të funksionimit sipas modelit në fjalë. Në fakt, është mese e qartë se bankat nuk janë të prirura për ndonjë zgjerim më të konsiderueshëm të funksionimit të tyre me aktivitete jotradicionale, e të cilat do u kishin sjellë të hyra shtesë nga provizionet, dhe për pasojë një diversifikim më të shprehur të totalit të hyrave. Nga ana tjetër, ndryshueshmëria më e shprehur



e participimit të hyrave tjera jashtë-interesore vetëm e rikomfirmon karakterin kryesisht të rastësishëm të tyre.

Grafik 110

Struktura sektoriale e të ardhurave nga (majtas) dhe të dalurave për djathtas) interes në përqind



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave e paraqitura nga ana e bankave.

Në kontekst të shfrytëzimit të hyrave, në periudhën e krizës globale financiare, e deri në vitin 2010-2011, vërehet një zmadhim permanent i pjesëmarrjes së kostove operative (ulje e efikasitetit operativ), rritje e pjesëmarrjes së kostove për korrigjim të vlerës (dëmtim i portfolios kreditorë) dhe për pasojë edhe rënie e margjinave të fitimit (zvogëlim i participimit të fitimit në totalin e të hyrave të bankave). Megjithatë, duke filluar nga viti 2012, në mënyrë të konsiderueshme është përmirësuar efikasiteti operativ i bankave, si dhe menaxhimi me riskun kreditorë, që bashkërisht me rritjen solide të hyrave, ka mundësuar shuma më të konsiderueshme të fitimit.

Për një periudhë më të gjatë kohore (nga viti 2010 e në veçanti nga viti 2012 e këtej), në kushte të rënies permanente në normave të interesit, bankat kanë arritur që të mbajnë një nivel kryesisht stabil të hyrave në emër të normave të interesit, prej rreth 20 miliardë denarë, pa oscilime më të shprehura ndër vite.

Një nga faktorët që mundëson mbajtje të hyrave në emër të normës së interesit në nivel stabil është zgjerimi permanent i aktiviteteve interes-prurëse të bankave. Një faktor tjetër, e që ndoshta edhe më shumë kontribuon në nivelin e stabilitetit të hyrave në emër të normave të interesit, janë transformimet që vërehen te portfolio kreditorë të bankave. Në fakt, vërehet një trend i huazimit gjithnjë e më të madh të familjeve, sektor ky te i cili normat e interesit janë zakonisht më të larta (para së gjithash te kreditë për financim të konsumit të familjeve), që reflektoi në mënyrë përkatëse edhe në një rritje më të konsiderueshme të pjesëmarrjes së të ardhurave të familjeve në bazë të normës së interesit në totalin e të ardhurave të bankave në bazë të normës së interesit (në periudhën e viteve 2007-2017, pjesëmarrja e tyre është zmadhuar për gati 15 pikë përqindje, ndërsa nga viti 2016 e këtej, të ardhurat në bazë të interesit prej familjeve kanë pjesëmarrjen individuale më të lartë në totalin e të ardhurave nga normat e interesit). Nuk duhet lënë anësh as prezenca e denarizimit të portfoliove kreditorë, e cila në veçanti është përforcuar nga viti 2012 (me përforcimin e krizës së huazimit në eurozonë), duke u sjellë të ardhura më të shprehura nga normat e interesit bankave, duke pasur parasysh premin e inkorporuar për risk valutore në normat e interesit të kredive në denarë, në kushte të kursit de fakto fiks të këmbimit. Përfundimisht, duhet pasur parasysh se në kushte të rënies së normave të interesit, rëndom rënia e normave aktive të interesit është më e ulët dhe më e ngadaltë në krahasim më rënien e normave pasive të interesit (ang. loanratestickiness).

Edhe pranë shumën relativisht stabil të ardhurave në bazë të normave të interesit, të dalurat në emër të normave të interesit, që nga viti 2012 e këtej, kanë shënuar rënie të vazhdueshme, me shkallë të ndryshimit vjetorë thellë të pozicionuara në zonën negative (megjithatë në vitin 2016 dhe



në vitin 2017, shkallët negative të ndryshimit lëvizin telartë, që ndoshta sinjalizon një shterim gradual të hapësirës për shkurtime të mëtejme më të shprehura të dalurave në emër të normës së interesit). Në strukturën sektoriale të dalurave në bazë të normës së interesit, që nga viti 2019, më e madhe (por rënese që nga viti 2014) është participimi i të dalurave në emër të normës së interesit nga puna me familjet. Lëvizjet e tilla sinjalizojnë se shkurtimi i totalit të dalurave në emër të normës së interesit është bërë kryesisht përmes zvogëlimit të dalurave në emër të normës së interesit për familjet. Në dobi të rënies së të dalurave në emër të normës së interesit për këtë sektor shkojnë edhe ndryshimet në strukturën e depozitave të familjeve. Në fakt, në periudhën paraprake, depozitat në shikim kanë komponenti me shpejtësi më të lartë të rritjes në strukturën e totalit të depozitave të familjeve, e cila sjell të dalura më të ulta në emër të normës së interesit, ndërsa gjatë disa viteve të fundit aspak nuk ka rezultuar me të dalurave në emër të normës së interesit për bankat (një pjesë e madhe e bankave, në politikat e tyre të normave të interesit, nuk parashikojnë pagesë të normës së interesit për depozitat në të pamur).

Në kushte të mungesës së rikapitalizimeve më të konsiderueshme të bankave, është mese e qartë se fitimet e realizuara janë burimi më i rëndësishëm i zmadhimit të pozicioneve kapitale. Rëndësia e tyre, në veçanti vjen në shprehje, në kushte të kërkesave të përforcuara regullatore dhe supervizuese në lidhje me madhësinë dhe cilësinë e pozitave kapitale të bankave. Nga këtu, ruajtja e një profitabiliteti stabil dhe të lartë është një sfidë e rëndësishme për bankat për shkak të ruajtjes së pozitave kapitale në nivele të duhura, pa mos u rrezikuar sasia e aktiviteteve dhe ndërmjetësimit financiar që ato e realizojnë. Kjo sfidë, veçanërisht vjen në shprehje në kushte të një përqendrimi më të shprehur të totalit të hyrave të bankave, rreth të ardhura neto në bazë të normave të interesit, e në kushte të niveleve historikisht të ulët dhe rrenëse të normave të interesit, madhësia reale e të cilave në veçanti është zvogëluar në vitin 2017 (për shkak të përshpejtimit të shkallës së inflacionit).



Shtojca 1

Lidhshmëria e treguesve të firmave të veçanta nga sektori korporativ dhe niveli mesatar i tyre në rrezikshmërinë e sistemit bankar

Pas mbarimit të projektit për lidhshmërinë e të dhënave nga Regjistri i kredisë me të dhënat nga llogaritë vjetore që BPRM i merr nga Regjistri qendror, është bërë tentimi i parë i identifikimit të zërave dhe treguesve nga raportet financiare të cilët do mundet të shpjegojnë dinamikën dhe korigjimin e vlerës së personave që janë kyçur në sektorin korporativ. Në emër të kësaj është realizuar një analizë e zhvillimit të grupit të përzgjedhur të treguesve më relevant (nga lista e gjerë e treguesve) për 18,802 persona juridik nga sektori korporativ për vitin 2016 (17,634 për 2015 dhe 17,767 për vitin 2014) në varshmëri nga klasifikimi i personave juridik në aspekt të statusit të klientit "I rregullt" / "Jofunksional" (definuar në bazën e të dhënave si vlere korigjuese gjithsej/ekspozimi gjithsej nën dhe mbi 30%, përkatësisht) dhe në nivelin e korigjimit të vlerës nga persona juridik të veçantë. Gjithashtu, personat te të cilët është konstatuar statusi i rregullt i ekspozimit kreditues janë ndarë në disa interval sipas nivelit të ndarë të vlerës kredituese. Treguesit që identifikojnë ndryshimin më të madh në treguesin përkatës gjatë ndryshimit të nivelit mesatar të rrezikut janë prezantuar edhe grafikut, me tregim të veçantë të medianës së tyre dhe dhe dallimet interkuartale. Sipas asaj që është treguar në tabelat dhe grafikut, duket se treguesit e profitabilitetit, dhe në veçanti margjina e fitimit operativ dhe margjina e fitimit neto, kanë rëndësinë më të madhe shpjeguese për nivelin e rrezikut të kredisë. Njëherit, te disa tregues (p.sh. treguesi për ngarkesën e përgjithshme me borxh ose treguesi për mbulimin e shpenzimeve nga interesi me fitim operativ) vërehet se personat juridik nga sektori korporativ për të cilët korigjimi i vlerës është në intervalin nga 5% gjer 10%, kanë shmangie të dukshme nga ajo që ishte e pritur si trajektore e zhvillimi për medianen e këtyre treguesve, që na tregon se ka ndonjë problem me të dhënat kontabël me personat juridik në këtë grup, ose nga ana tjetër, tregon diferenca në nivelin e konzervativitetin midis bankave gjatë përcaktimit të vlerës korigjuese për kreditë e miratuara.

Në vazhdim është e dhen lista për mënyrën e përlllogaritjes së treguesve të shfrytëzuar gjatë kësaj analize por edhe për treguesit tjerë për funksionimin e sektorit bankar.



Treguesit	Mënyra e përlogaritjes
NGARKESA ME BORXH	
Treguesi i ngarkesës totale me borxh	(Gjithsej mjetet - kryegjëja dhe rezervat) / Gjithsej mjetet
Treguesi Borxh / Kapital	(Gjithsej mjetet - kryegjëja dhe rezervat) / Gjithsej kryegjëja dhe rezervat
Treguesi për ngarkesë afatgjata me borxh	(Rezervimet afatgjata për rreziqe dhe shpenzime + Detyrimet afatgjata) / (Rezervimet afatgjata për rreziqe dhe shpenzime + Detyrimet afatgjata + Kryegjëja dhe rezervat)
Tregues Mjete / Kapital (herë)	Mjetet / Kryegjëja dhe rezervat
Borxhi me interes / Kapital (herë)	(Detyrimet në bazë të kredive, duke përfshirë edhe kredit e personave të ndërlidhur + Detyrimet financiare tjera + Rezervimet afatgjata për përfitime të punonjësve) / (Kryegjëja dhe rezervat)
Borxhi afatgjatë me interes / Gjithsej kapitali i angazhuar	(Detyrimet në bazë të kredive, duke përfshirë edhe kredit e personave të ndërlidhur + Detyrimet financiare tjera + Rezervimet afatgjata për përfitime të punonjësve) / (Detyrimet afatgjata në bazë të kredive, duke përfshirë edhe kredit e personave të ndërlidhur + Detyrimet financiare tjera + Rezervimet afatgjata për përfitime të punonjësve + Kryegjëja dhe rezervat)
Treguesi i mbulimi të shpenzimeve të financimit	EBIT (Fitimi nga veprimtaria afariste) / Shpenzimet financiare
treguesi i mbulimeve të shpenzimeve nga interesi	EBIT (Fitimi nga aktivitetet afariste) / Shpenzimet e interesit
EBIT (Fitimi nga aktiviteti afarist)	Të ardhurat nga operative - Shpenzimet operative
LIKUIDITETI	
Likuiditeti rrjedhës	Mjetet rrjedhëse / (Detyrimet afatshkurtra + NKP)
Likuiditeti i shpejt	(Mjetet rrjedhëse - Stoqet) / (Detyrimet afatshkurtra + NKP)
Likuiditeti në para	(Mjetet financiare afatshkurtra + Mjetet para dhe ekuivalentët e parave) / (Detyrimet afatshkurtra + NKP)
Kapitali punues neto	Mjetet rrjedhëse - Detyrimet afatshkurtra-NKP
EFIKASITETI NË SHFRYTËZIMIN E MJETEVE	
Ditët e lidhura të kërkesave	365 / Qarkullimi i kërkesave
Ditët e lidhura të kërkesave rrjedhëse	366 / Qarkullimi i kërkesave rrjedhëse
Ditët e lidhura të stoqeve	365 / Qarkullimi i stoqeve
Ditët e shlyerjes së detyrimeve afatshkurtra	Detyrimet afatshkurtra (mesatarja e dy viteve të njëpasnjëshme)*365 / Shpenzimet nga puna pa efektet e deprecimit, amortizimit dhe nivelizimi i vlerës së mjeteve
Qarkullimi i gjithsej mjeteve	Të ardhurat operative / Mesatarja e aktivit gjithsej e dy viteve të njëpasnjëshme
Qarkullimi i stoqeve	Të ardhurat operative / Mesatarja e stoqeve nga dy vitet e njëpasnjëshme
Qarkullimi i kërkesave	Të ardhurat operative / Mesatarja e kërkesave afatshkurtra dhe afatgjata nga dy vitet e njëpasnjëshme
Qarkullimi i kërkesave rrjedhëse	Të ardhurat operative / Mesatarja e kërkesave afatshkurtra e dy viteve të njëpasnjëshme
Qarkullimi i mjeteve fikse	Të ardhurat operative / Mesatarja e (investime në patundshmëri + mjete materiale) për dy vite të njëpasnjëshme
Qarkullimi i kapitalit punues neto	Të ardhurat operative / Kapitali punues neto
Qarkullimi i kapitalit dhe rezervave	Të ardhurat operative / Kapitali dhe rezervat mesatare në dy vitet e njëpasnjëshme
Mbulimi i mjeteve operative jorrijedhëse me burime afatgjata të financimit	(Kryegjëja dhe rezervat + rezervimet afatgjata për rreziqe + detyrimet afatgjata) / (Mjetet jomateriale + Mjetet materiale + Investimet në patundshmëri)
Mjetet jo rrjedhëse operative / Aktivi gjithsej	(Mjetet jomateriale + Mjetet materiale + Investimet në patundshmëri) / Gjithsej aktivi
PROFITABILITETI	
Kthimi në aktivin mesatar - ROAA	Neto fitimi (Humbja) / Mesatarja e aktivit gjithsej nga dy vite të njëpasnjëshëm
Kthim në kapitalin dhe rezervat mesatare - ROAE	Neto fitimi (Humbja) / Mesatarja e kapitalit dhe rezervave nga dy vitet e njëpasnjëshëm
Marzhi i profitit neto	(Neto fitimi për vitin kontabël - Neto humbja për vitin kontabël) / Të ardhurat operative
Kthimi i kapitalit mesatar të angazhuar - ROCE	EBIT / Mesatarja nga (Kryegjëja dhe rezervat+ Rezervimet afatgjata dhe rreziqet + Detyrimet afatgjata) dy vite të njëpasnjëshëm
Fitimi operativ / Aktivi gjithsej	EBIT / Gjithsej aktivi
Marzhi i fitimit operativ	EBIT / Të ardhurat operative
Të hyrat nga veprimtaria e rregullt për punonjës, në milionë denarë (treguesi i produktivitetit)	Të ardhurat nga veprimtaria e rregullt për punonjës / Numri i punonjësve (të dhënat e numrit të punonjësve është marur nga njoftimet e ESHS)
Neto fitimi pas tatimit për punonjës, në milionë denarë (treguesi i produktivitetit)	Neto fitimi pas tatimit / Numri i punonjësve (të dhënat e numrit të punonjësve është marur nga njoftimet e ESHS)

Tabela 1

Mediana, tremujori i parë dhe i tret për firmat nga sektori korporativ sipas nivelit të mbulimit të ekspozimit kreditues me korigjimin e vlerës, për disa tregues të veçantë më të rëndësishëm (me gjendje 31.12.2014)

31.12.2014		1.1.	1.4.	1.5.	1.9.	2.1.	3.7.	3.8.	3a.1.	3a.2.	4a.1.	4a.5.	4a.8.	4a.9.	5.3.	5.9.	5.15.
		Treguesi i ngarkesës totale me borxh (%)	Tregues Mjete / Kapital (herë)	Borxhi me interes / Kapital (herë)	Treguesi i mbulimi të shpenzimeve të interesit (herë)	Likuiditeti rrjedhës (herë)	Marzhi i profitit neto (%)	Marzhi i fitimit operativ (%)	Kthime në aktiv - ROA(%)	Kthimi i kapitalit dhe rezervave-ROE (%)	Qarkullimi i gjithsej mjeteve (herë)	Qarkullimi i kërkesave rrjedhëse (herë)	Ditët e lidhura të stoqeve (ditë)	Ditët e lidhura të kërkesave (herë)	Të ardhurat operative (rritja vjetore)	Mjetet rrjedhëse (rritja vjetore)	Borxhi me interes (rritja vjetore)
MEDIANA	HΦK	72.83	1.30	0.00	-1.53	0.96	-2.13	-1.88	-0.15	0.92	0.27	1.08	39.50	251.00	-13.09	-0.01	0.00
	20-30%	72.66	1.77	0.10	0.99	1.06	0.27	0.61	0.11	1.87	0.58	2.24	71.37	150.83	-8.82	-1.57	0.00
	10-20%	71.40	2.21	0.19	2.19	1.16	0.92	1.97	0.63	3.32	0.71	2.77	54.90	129.92	-2.03	0.21	0.00
	5-10%	46.36	1.43	0.00	317.25	1.51	1.60	1.95	2.25	7.33	1.49	7.21	27.74	50.35	12.15	9.05	0.00
	1-5%	53.89	1.84	0.23	9.31	1.39	1.82	3.01	2.09	6.49	1.09	4.24	41.74	86.04	3.95	5.54	0.00
	0-1%	51.92	1.85	0.26	8.97	1.47	2.49	3.91	2.70	7.44	1.07	3.86	44.12	94.57	5.70	7.15	0.00
T1	HΦK	34.03	-0.18	0.00	-80,822	0.35	-128.02	-126.26	-13.10	-7.77	0.01	0.04	0.00	40.17	-70.65	-22.64	-7.40
	20-30%	43.71	0.00	0.00	-111.73	0.57	-33.17	-31.62	-7.15	-9.36	0.16	0.74	1.77	45.87	-48.98	-17.05	-19.71
	10-20%	42.29	1.19	0.00	-7.95	0.72	-4.94	-9.21	-2.60	0.00	0.31	1.07	6.59	44.43	-32.00	-14.62	-22.39
	5-10%	19.30	1.07	0.00	-115.40	0.82	-2.98	-3.98	-3.68	0.06	0.74	2.61	0.00	9.99	-9.92	-12.77	-5.59
	1-5%	30.34	1.26	0.00	1.06	0.88	0.24	0.37	0.20	0.76	0.59	1.93	3.24	35.16	-14.26	-11.16	-21.93
	0-1%	31.95	1.35	0.05	1.36	0.96	0.40	0.77	0.39	1.31	0.60	1.97	3.97	42.74	-12.61	-9.70	-24.85
T3	HΦK	115.94	2.70	0.18	2,870.76	1.91	3.67	4.88	2.04	17.93	0.97	5.59	297.92	2,533.30	18.16	13.30	0.00
	20-30%	100.76	3.53	0.82	21.08	1.82	3.52	6.47	3.05	17.48	1.21	7.45	240.03	429.84	23.17	19.06	12.74
	10-20%	91.12	4.26	1.07	14,239.00	1.97	4.29	8.77	3.98	20.86	1.29	7.95	187.55	314.76	42.53	30.07	15.21
	5-10%	80.81	2.48	0.22	89,606.25	3.44	8.08	9.00	12.21	35.58	2.81	35.91	101.16	138.55	68.06	66.46	14.06
	1-5%	78.24	3.15	0.84	28,270.27	2.54	6.91	9.14	8.39	21.32	1.98	10.33	126.81	188.56	31.84	33.68	87.35
	0-1%	74.32	3.02	0.76	23,138.00	2.56	7.70	10.04	8.90	22.55	1.79	8.56	135.56	185.57	30.18	32.36	99.65

Burimi: BPRM, sipas të dhënave nga llogaritë vjetore.

Tabela 2

Mediana, tremujori i parë dhe i tret për firmat nga sektori korporativ sipas nivelit të mbulimit të ekspozimit kreditues me korigjimin e vlerës, për disa tregues të veçantë më të rëndësishëm (me gjendje 31.12.2015)

31.12.2015		1.1.	1.4.	1.5.	1.9.	2.1.	3.7.	3.8.	3a.1.	3a.2.	4a.1.	4a.5.	4a.8.	4a.9.	5.3.	5.9.	5.15.
		Treguesi i ngarkesës totale me borxh (%)	Tregues Mjete / Kapital (herë)	Borxhi me interes / Kapital (herë)	Treguesi i mbulimi të shpenzimeve të interesit (herë)	Likuiditeti rrjedhës (herë)	Marzhi i profitit neto (%)	Marzhi i fitimit operativ (%)	Kthime në aktiv - ROA(%)	Kthimi i kapitalit dhe rezervave-ROE (%)	Qarkullimi i gjithsej mjeteve (herë)	Qarkullimi i kërkesave rrjedhëse (herë)	Ditët e lidhura të stoqeve (nati)	Ditët e lidhura të kërkesave (herë)	Të ardhurat operative (rritja vjetore)	Mjetet rrjedhëse (rritja vjetore)	Borxhi me interes (rritja vjetore)
MEDIANA	НФК	70.76	1.30	0.00	0.00	1.03	0.00	0.00	0.00	1.63	0.41	1.78	36.62	204.11	-11.24	-0.76	0.00
	20-30%	74.90	1.76	0.04	1.14	1.11	0.35	1.16	0.19	3.47	0.61	3.01	56.63	119.42	-6.51	-0.33	0.00
	10-20%	71.93	2.01	0.17	2.41	1.10	0.81	1.58	0.68	3.55	0.74	3.74	59.21	98.04	0.34	0.15	0.00
	5-10%	46.72	1.46	0.00	355.30	1.51	1.73	2.11	2.21	6.87	1.51	7.57	26.50	48.64	8.42	11.21	0.00
	1-5%	53.78	1.86	0.24	11.74	1.36	2.28	3.58	2.48	7.09	1.08	4.19	42.22	87.42	4.11	8.92	0.00
	0-1%	51.24	1.85	0.26	12.11	1.49	2.96	4.31	3.14	8.09	1.08	3.92	42.09	93.48	5.17	9.18	0.00
T1	НФК	31.91	-0.14	0.00	-64,048	0.40	-60.39	-59.33	-13.54	-8.86	0.10	0.41	0.00	42.54	-61.83	-21.85	-10.77
	20-30%	40.01	1.01	0.00	-126.01	0.64	-23.38	-20.79	-8.97	-5.22	0.26	1.03	0.57	50.74	-40.31	-17.30	-24.99
	10-20%	46.18	1.08	0.00	-8.14	0.62	-13.44	-13.06	-4.71	-1.62	0.31	1.30	3.68	39.20	-31.86	-16.64	-19.25
	5-10%	19.91	1.08	0.00	-77.05	0.83	-1.98	-3.44	-2.61	0.08	0.75	2.79	0.00	10.44	-12.80	-9.46	-0.69
	1-5%	31.02	1.28	0.01	1.23	0.88	0.33	0.56	0.32	0.98	0.57	2.02	3.84	35.59	-14.66	-8.35	-21.24
	0-1%	30.95	1.33	0.04	1.65	0.97	0.56	0.94	0.59	1.56	0.62	2.06	3.49	40.26	-12.27	-6.69	-23.43
T3	НФК	113.51	2.64	0.20	15,040.75	2.13	6.51	8.51	3.44	20.54	1.16	8.31	227.45	853.54	30.01	14.35	0.00
	20-30%	98.33	4.20	0.83	6,102.69	1.97	4.51	7.85	4.30	33.76	1.28	7.19	221.05	353.86	29.15	22.36	9.08
	10-20%	94.98	4.11	0.96	7,409.00	1.65	4.36	7.56	4.11	20.31	1.65	9.31	182.21	283.34	40.34	28.29	18.48
	5-10%	79.94	2.53	0.26	86,851.00	3.52	8.27	9.21	12.34	32.01	2.84	35.34	97.99	131.09	66.07	70.34	18.22
	1-5%	77.70	3.14	0.85	27,888.00	2.56	7.99	10.16	9.01	23.72	1.89	10.29	126.27	180.37	30.90	37.58	77.41
	0-1%	73.10	2.99	0.79	25,497.44	2.58	8.67	10.56	9.56	23.16	1.82	9.09	125.32	177.29	28.60	36.07	94.19

Burimi: BPRM, sipas të dhënave nga llogaritë vjetore.

Tabela 3

Mediana, tremujori i parë dhe i tretë për firmat nga sektori korporativ sipas nivelit të mbulimit të ekspozimit kreditues me korigjimin e vlerës, për disa tregues të veçantë më të rëndësishëm (me gjendje 31.12.2016)

31.12.2016		1.1.	1.4.	1.5.	1.9.	2.1.	3.7.	3.8.	3a.1.	3a.2.	4a.1.	4a.5.	4a.8.	4a.9.	5.3.	5.9.	5.15.
		Treguesi i ngarkesës totale me borxh (%)	Tregues Mjete / Kapital (herë)	Borxhi me interes / Kapital (herë)	Treguesi i mbulimi të shpenzimeve të interesit (herë)	Likuiditeti rrjedhës (herë)	Marzhi i profitit neto (%)	Marzhi i fitimit operativ (%)	Kthime në aktiv - ROA(%)	Kthimi i kapitalit dhe rezervave-ROE (%)	Qarkullimi i gjithsej mjeteve (herë)	Qarkullimi i kërkesave rrjedhëse (herë)	Ditët e lidhura të stoqeve (ditë)	Ditët e lidhura të kërkesave (herë)	Të ardhurat operative (rritja vjetore)	Mjetet rrjedhëse (rritja vjetore)	Borxhi me interes (rritja vjetore)
MEDIANA	HФK	72.59	1.27	0.00	-1.96	1.01	-1.50	-2.28	-0.02	0.81	0.27	1.07	33.92	257.20	-10.89	0.00	0.00
	20-30%	69.01	1.66	0.02	1.56	1.14	0.82	1.35	0.45	4.37	0.68	3.10	32.11	110.05	-4.36	1.78	0.00
	10-20%	73.49	2.03	0.18	2.20	1.10	0.82	1.71	0.64	4.29	0.72	3.25	60.88	109.05	-1.57	0.01	0.00
	5-10%	46.62	1.43	0.00	242.75	1.48	1.65	1.94	2.17	6.61	1.44	7.67	24.98	47.36	7.18	10.74	0.00
	1-5%	52.36	1.80	0.23	10.41	1.44	2.38	3.60	2.67	7.56	1.08	4.31	39.39	84.29	4.28	7.96	0.00
	0-1%	50.68	1.85	0.26	12.52	1.50	3.35	4.74	3.45	8.59	1.02	3.81	41.40	95.73	5.15	8.18	0.00
T1	HФK	32.38	-0.17	0.00	-85,072	0.38	-151.20	-152.24	-12.95	-6.86	0.01	0.02	0.00	42.44	-70.25	-18.39	-2.97
	20-30%	36.07	1.02	0.00	-3,643.66	0.62	-27.51	-27.40	-7.03	-3.00	0.24	1.02	0.00	38.95	-39.79	-9.68	-22.33
	10-20%	46.42	1.11	0.00	-25.78	0.61	-10.01	-10.47	-3.56	0.05	0.31	1.14	5.42	36.47	-28.70	-17.88	-26.39
	5-10%	18.95	1.08	0.00	-140.68	0.83	-2.39	-3.67	-2.93	0.12	0.75	2.81	0.00	9.25	-11.06	-9.73	0.00
	1-5%	29.67	1.26	0.00	1.20	0.89	0.29	0.45	0.31	1.06	0.60	2.10	2.80	34.47	-12.68	-8.64	-24.38
	0-1%	29.89	1.32	0.03	1.73	0.95	0.68	1.12	0.61	1.82	0.58	2.04	3.05	44.55	-10.32	-6.07	-20.44
T3	HФK	118.60	2.63	0.21	2,278.00	2.14	3.36	4.30	2.06	15.03	1.00	5.72	317.25	3,556.34	14.24	12.71	0.00
	20-30%	97.22	3.59	0.60	17,753.00	2.03	9.00	11.30	7.67	29.95	1.55	7.93	197.45	304.66	17.60	33.98	2.21
	10-20%	94.72	4.20	1.03	3,668.44	1.70	5.29	7.95	4.13	25.39	1.60	9.59	212.68	299.64	27.79	20.96	9.76
	5-10%	79.76	2.54	0.27	72,387.50	3.54	7.94	8.94	11.48	32.26	2.72	39.12	99.59	129.08	52.18	60.32	23.39
	1-5%	75.85	2.98	0.77	13,078.25	2.55	8.39	10.37	9.39	24.20	1.90	10.41	124.74	172.66	27.62	33.42	65.62
	0-1%	72.12	2.93	0.79	6,617.00	2.66	9.19	11.20	9.86	23.44	1.69	8.16	123.75	179.34	28.78	32.37	74.06

Burimi: BPRM, sipas të dhënave nga llogaritë vjetore.


¹ Mediana, si masë e tendencës qendrore është një vlerë që ndan serinë statistikore në dy pjesë të barabarta, anëtarët e së cilës janë rregulluar sipas një radhe zbritëse ose rritëse, d.m.th. gjysma e vëzhgimeve janë më të mëdha dhe gjysma tjetër ka vlerë më të ulët se mediana. Mediana identifikohet me tremujorin e dytë, përkatësisht T2 dhe tremujorin e parë T1, apo edhe "vlerë nën medianes" e përfshinë çerekun e parë të serisë statistikore si vlerë mesatare në mes medianës dhe vlerës më të vogël në seri (minimumin), tremujori i tretë, përkatësisht T3, është vlera në të cilën shtrihen 75% e observimeve në serinë statistikore dhe paraqiten si vlera mesatare në mes medianës dhe vlerës maksimale në seri. (IQR) ose dallimi interkalar përlllogaritë si dallim në mes T3 dhe T1 me çka përjashton ndikimin e 25% e të dhënave me vlera më të vogla dhe 25% nga të dhënat me vlera më të larta, përkatësisht e mat shpërndarjen e 50% nga të dhënat e përgjithshme.




Grafik 1

Ndërvarësia e nivelit mesatar të rrezikut nga kompanitë individuale nga sektori i korporatave dhe treguesit përkatës të përzgjedhur më 31.12.2015, mediana (majtas) dhe diferenca interkalare (djathtas):


- Për ngarkesën e përgjithshme me borxh,




- Likuiditeti rrjedhës ,




- Marzhi i fitimit neto



- Marzhi i fitimit operativ



- Të ardhurat nga puna




Burimi: BPRM, sipas të dhënave nga llogaritë vjetore.

Grafik 2


Ndërvarësia e nivelit mesatar të rrezikut nga kompanitë individuale nga sektori i korporatave dhe treguesit përkatës të përzgjedhur më 31.12.2016, mediana (majtas) dhe diferenca interkalare (djathtas):

- Për ngarkesën e përgjithshme me borxh,







- Likuiditeti rrjedhës,




- Marzhi i fitimit neto,



- Marzhi i fitimit operativ и



- Të hyra nga puna



Burimi: BPRM, sipas të dhënave nga llogaritë vjetore.

Në bazë të grafikeve dhe tabelave të treguara, mundemi të konstatojmë se, bankat kryesisht ndajnë vlerë më të lartë të korigjimit të vlerës, përkatësisht shqyrtojnë se ka një nivel më të lartë rreziku të kompanitë që kanë tregues më të këqij financiar ose treguesit financiarë të cilët përkeqësohen. Rritja e korigjimit të vlerës korespondon me përkeqësimin e treguesve:

- Profitabiliteti i firmave nga sektori korporativ (marzhi operativ neto, marzhi i fitimit operativ, ROAA dhe ROAE zvogëlohen),
- Likuiditeti (zvogëlohet treguesi i likuiditetit rrjedhës),
- Ngarkesa me borxh (treguesi i ngarkesës së përgjithshme me borxh rritet, ndërsa treguesit Mjete/Kapital, Borxhi me pasojë interesi/Kapital zvogëlohet, ngarkesa e fitimit operativ me pagesa të interesit rritet,
- Efikasiteti i aktiviteteve.

Përfundim nga kjo lidhje në mes treguesve financiar dhe vëllimi të vlerës korigjuese vërehet tek personat juridik të sektori korporativ për të cilët korigjimi i vlerës gjendet në intervalin nga 5% gjer 10%. Përkatësisht, këto kompani kanë tregues më të mirë nga kompanitë ku për borxhin e tyre kanë përcaktuar korigjim vlerorë nën 5%.